

## PROÇESVERBAL I MBLEDHJES DATËS 29 Dhjetor 2023

Kryesuesi i mbledhjes është: Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi

Ora e hapjes së mbledhjes: 11:00

Zhvillimi i mbledhjes: në sallën e Këshillit Bashkiak

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes: 28

Sekretari i Këshillit deklaroi kuorumin prej këshilltarësh: 28

Të pranishëm nga administrata e Bashkisë: Kryetari i Bashkisë Sotiraq Filo, zv/kryetarët

Kletjon Kita, Benila Themeli, Besa Spaho, kabineti i kryetarit dhe Drejtorë të Administratës

Të pranishëm në mbledhje qytetarë: 1

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Mirëdita të gjithëve, meqënëse kourumi është ngritur fillojmë këtë mbledhje e cila është një nga mbledhjet më të rëndësishme të këtij viti 2023, ju është shpërndarë të gjithë këshilltarëve rendi i ditës i cili është miratuar edhe në kryesi, por unë i propozoj këshillit përpara sesa ta miratojë këtë rend dite futjen e një materiali i cili ka erdhur pak me vonesë për shkak të daljes me vonesë të VKM-së që ka të bëjë me dhënien e shpërblimit për familjet në nevojë që trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi i buxhetit vendor për muajin dhjetor 2023 dhe që duhet të shpërndahet brenda këtyre ditëve. Unë mendoj që kjo pikë e rendit të ditës të kalojë pika e tretë e rendit të ditës dhe për këtë kërkoj miratimin tuaj dhe së dyti duke qënë se renditja e materialeve, jo sepse nuk u është shpërndarë duke qënë se renditja e materialeve në rendin e ditës të tematikave është bërë sipas ardhjes të materialeve dhe unë mendoj që miratimin e pagave të punojësve dhe e personave të tjerë të zgjedhur ose emëruar të institucioneve të bashkisë dhe institucioneve të varësisë për vitin 2024 duhet të miratohet përpara relacionit mbi projektbuxhetin e bashkisë Korçë të vitit 2024 dhe PBA 2024-2026, kështu që zhvendosje e pikave të rendit të ditës nga pika 8 kalojë në pikën 7 dhe anasjelltas pika 7 të kalojë në pikën 8 të rendit të ditës. Kush është dakort me këto propozime?

Këshilltar D.Osmani: Përshendetje, cila është arsyeja që duhet ti zhvendosim ?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Sepse niveli i pagave i punojësve dhe personave të tjerë të zgjedhur duhet si procedurë të jetë përpara miratimit të buxhetit sepse me buxhetin ne miratojmë dhe këtë nivel të pagave. E hedhim në votim rendin e ditës me propozimet që ju paraqita.

### **Pika 1 e rendit të ditës.**

**PËR MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS.**

Hidhet ne votim dhe miratohet

Vota PRO 28

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

## **Pika 2 e rendit të ditës.**

PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË DATËS 7- DHJETOR 2023 DHE TE DATËS 20-DHJETOR 2023.

Hidhet ne votim dhe miratohet

Vota PRO 28

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

## **Pika 3 e rendit të ditës.**

MBI DHËNIEN E SHPËRBLIMIT PËR FAMILJET NË NEVOJË QË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE, NGA FONDI I BUXHETIT VENDOR, PËR MUAJIN DHJETOR 2023.

Këshilltare E.Mitre: Përshendetje të gjithëve, atëherë materiali që ka erdhur dhe që u fut në rendin e ditës me miratimin tuaj është mbi dhënie e shpërblimit për familjet në nevojë që trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi i buxhetit vjetor për muajin dhjetor 2023. Kjo është e bazuar mbi vendimin NR 766 datë 20.12.2023 për shpërblimin e disa kategorive të veçanta për këtë dhe nga këtë relacion shprehimisht thuhet që nga buxheti vendor do të përfitojnë shpërblim financiar 19 familje me masën pesë mijë lekë për secilën familje me një fond prej nëntëdhjetë e pesë mijë lekë, këto janë familje që i përkasin ndihmës ekonomike dhe relacioni ka erdhur nga drejtorja e kujdesit social, në relacion kemi dhe listën e 19 familjeve që përfitojnë ndihmën ekonomike prej pesë mijë lekësh, ju ftoj ta miratoni këtë material.

Hidhet ne votim dhe miratohet

Vota PRO 31

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

## **Pika 4 e rendit të ditës.**

MBI MIRATIMIN E FAMILJEVE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI SOCIAL I STREHIMIT, " SUBVENCIONIMI I INTERESAVE TË KREDISË ".

Këshilltare E.Mitre: Nga drejtorja e strehimit na ka erdhur relacioni për 7 familje të cilat përfitojnë në bazë të ligjit dhe në bazë të pikëzimit që ata kanë përfituar nga kjo dhe në bazë të dokumentacionit që kanë paraqitur pranë kësaj drejtorie, kuptohet që në mbledhjen e djeshme të komisionit së bashku me ZNJ. Mirela kemi diskutuar për çështjet dhe problemet e kësaj situate dhe na është thënë nga ZNJ.Mirela që ka ende kuota të lira për këta njerëz që janë nevojë për strehim kështu që kësaj rradhe përfitojnë këto 7 familje, ju e keni tabelën dhe mund ta shihni të

gjitha kriteret që ata i kanë përmbushur, vazhdojnë të meren kërkesa akoma nga drejtoria e strehimit. Ju ftoj ta miratojmë dhe këtë material në ndihmë të këtyre familjeve.

Hidhet ne votim dhe miratohet

Vota PRO 32

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

### **Pika 5 e rendit të ditës.**

**PËR MIRATIMIN E PLANIT SOCIAL 2024-2027, BASHKIA KORÇË.**

Këshilltare A.Taho: Përshëndetje të gjithëve komisioni ka zhvilluar ditën e djeshme një takim me përfaqësues të drejtorisë dhe kujdesit social në bashkinë Korçë kemi diskutuar dhe kemi marrë informacionin e duhur për planin social, për herë të parë ky plan vjen i buxhetuar, unë duhet ti përgëzoj sepse ishte një model shumë i mirë dhe dhe kërkoj miratimin e këtij plani sepse ishin të përfshira të gjitha kategoritë në nevojë dhe besoj që për tre vitet e ardhshme do të jetë një punë shumë e mirë për të gjitha këto kategori që vërtet kanë nevojë. Ftoj këshilltarët ta miratojnë këtë plan.

Këshilltare A.Përmeti: Në lidhje me planin social e vlerësoj mënyrën sesi është paraqitur plani duke bërë një analizë të detajuar të situatës që lidhet me bashkinë Korçë duke vendosur dhe indikatorë se ku do të shkohet dhe me plan konkret për realizmin dhe mbështetjen e e të gjitha shtresave jo vetëm ato në nevojë por dhe pjesës të fëmijëve, grave. Kështu që nga eksperiencia ime është një plan e standartit bashkëkohor dhe i ftoj kolegët ta mbështesin në miratimin e buxhetit të vitit 2024.

Hidhet ne votim dhe miratohet

Vota PRO 32

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 1

### **Pika 6 e rendit të ditës.**

**PËR MIRATIMIN E BURSIVE PËR NXËNËSIT E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR PËR VITIN SHKOLLOR 2023-2024 NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE.**

Këshilltar A.Habip: Ekzekutivi i bashkisë Korçë mbështetur në shkresën 6470/95 të datës 20.11.2023 ka dërguar realcionin për miratimin e bursave për nxënësit e arsimit parauniversitar për vitin 2023-2024. Këtë e ka bazuar mbi vendimin NR.666 të datës 10.10.2019 i ndryshuar ku thuhet se njësitë e qeverisjes vendore për uljen e nivelit të braktisjes të shkollës mund të miratojnë bursa financiare për nxënësit e familjeve në nevojë, të cilët kanë nevojë për mësues

kujdestar dhe për frekuentimin e procesit mësimor. Bashkia ka treguar të detajuar dhe shkollat të cilat do të përfitojnë bursa. Këto shkolla janë: Shkolla "Asdreni" me 80 nxënës, Shkolla "Pandeli Cale" 42 nxënës dhe Shkolla "Isuf Dalipaj" në njësinë Mollaj me 4 nxënës. Ju ftoj që ta miratohet këtë relacion që ka dërguar Bashkia Korçë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Unë do doja që në dijeninë time propozohen 3 bursa të tjera shtesë për shkak të ardhjes të materialeve me vonesë të dokumentacionit me vonesë, do të doja t'ja jepja fjalën ekzekutivit.

Ekzekutivi S.Zguri: Shtojmë dhe 3 emra të nxënësve shtesë për mosplotësim në kohë të dokumentacionit, të 3 nxënësit i plotësojnë kriteret e përcaktuara të vendimit 666 të ndryshuar. Nga 126 që kishim propozuar në fillim dhe 3 nxënës shkojnë 129. Kemi shkollën "Asdreni" dhe "Naim Frashëri" 2 nga shkolla "Asdreni" dhe 1 nga shkolla "Naim Frashëri".

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Pra atij numri nxënësish të mbështetur nga Bashkia Korçë i shtohen dhe 3 numra të tjerë.

Këshilltar L.Petri: Faleminderit zonja Kryetare, e përsërites komisionin për punën e bërë unë dua të sjell një informacion që vitin e kaluar janë mbështetur me bursa nga Ministria 350 familje dhe 133 familje me ndihmë ekonomike mbetën jashtë skemës mbështetëse, kjo bëri që të celej një fond i veçantë nga ana e bashkisë posaçërisht për këto 133 familje. Këtë vit nga të dhënat që kemi marrë nga shkollat dhe nga komisioneri për mbrojtjen dhe diskriminimin na rezulton që mbështetjen me bursa e kanë marrë vetëm familjet me punëkërkuar të papunë dhe ata me ndihme ekonomike nuk janë konsideruar. Pyetja që unë kam në cilësinë e këshilltarit është se çfarë metodologjie është përdorur për përzgjedhjen, pse nuk janë futur dhe emrat me ndihme ekonomike për tu mbështetur ashtu si ramë dakort dhe me zonjën Tare e pranishme në mbledhjen e kaluar?

Ekzekutivi S.Zguri: Janë marrë 2 kriteret, kriteri ekonomik dhe joekonomik në kriterin ekonomik është shkronja c në nënësit fëmijë të familjeve në nevojë që janë rregjistruar në arsimin bazë por në pamundësi financiare që nuk trajtohen as me ndihmë ekonomike dhe janë të papunë këta janë konsideruar dhe kemi në shkresën e Ministrisë me protokoll 64 70/55. Është marrë pika 2 shkronja c në pamundësi financiare kemi 2 shkresa nga Ministria e Arsimit.

Këshilltar L.Petri: Bashkia do të celë përsëri një fond të posaçëm për të mbështetur familjet e tjera që mbeten jashtë skemës.

Drejtoresha e Finances Bona: Duke zbatuar të gjitha kriteret e vendimit 666 janë paraqitur 479 bursa këtu përfshihet kriteri ekonomik dhe joekonomik.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Pyetja ishte vitin e kaluar 350 fëmijë u mbështetën me burse nga Ministria dhe 133 u mbështetën nga Bashkia. Si është situata këtë vit?

Situata këtë vit është që janë 479 që janë konsideruar në bazë të VKM-së përkatëse nga kriteri ekonomik dhe joekonomik nga këta 350 mbështeten nga ministria përsëri dhe 129 mbështeten nga Bashkia që është materiali që do miratohet, pra nuk ka shtesë tjetër lista është filtruar nga ndërmarja e shërbimeve mbështetëse pra gjithë aplikimeve që kanë erdhur nëpërmjet drejtorive

të shkollave janë filtruar në bazë të kriterit ekonomik dhe jo ekonomik dhe ka dalë kjo lista me 479 fëmijë.

Këshilltar L.Petri: Falemindeerit zoti Kryetar për sqarimin, unë mendoj që informacioni nuk është i mjaftueshëm sepse për ndryshe dhe komisioneri për diskriminin nuk ka pse të dalë me deklaratën që nuk janë përfshirë fare familjet që kanë ndihmë ekonomike.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Më fal kush është komisioneri?

Këshilltar L.Petri: Zonja Etleva Tare.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Zonja Etleva Tare nuk është komisioner kundër diskriminimit.

Këshilltar L.Petri: Këtë status ka Zoti Kryetar.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Tani për të qënë korrekt nga terminologjia ligjore, komisioneri kundër diskriminimit është një është në Tiranë Robert Gala. Komisioneri ka një zyrë lokale në bashkinë e Korçës dhe personi që ju përmëndët është punojëse e kësaj zyre. Tani shqetësimi për familjet me ndihmë ekonomike, shpjegimi që u dha nga ndërrmarja është që konsiderohen familje që kanë të ardhura. Ka ndonjë përcaktim kjo VKM-ja në kriteret ekonomike dhe joekonomike që familjet me ndihmë ekonomike duhet të përfshihen ne trajtimin e fëmijëve me bursa?

Këshilltar L.Petri: E ka përcaktimin që nuk duhet të përjashtohen.

Drejtoresha e Finances Bona: Nxënësit femijë të familjeve në nevojë që janë rregjistruar në arsimin bazë por në pamundësi financiare që nuk ndjekin arsimin bazë.

Këshilltare E.Mitre: Atëherë të gjithë e kemi dëgjuar dhe e kemi në vëmendje, bindjen për të ndjekur arsimin profesional të nxënësve nga arsimi i përgjithshëm deri tek ai profesional. Kam një pyetje për ekzekutivin ose drejtorinë përkatëse nëse numri i këtyre nxënësve në arsimin profesional do të rritet do të përfshihen këta nxënësit e rregjistruar në fondin e bursave dhe ne si bashki çfarë duhet të bëjmë ?

Këshilltare A.Taho: Eda e ka fjalën sepse ka një urdhër të dy ministrive deri ne datë 31 të këtij viti mund të kryhen tranferime të nxënësve nga gjimnazi drejt shkollave profesionale dhe mund të ketë nxënës të cilët nuk kanë arritur në kohë të plotësojnë dokumentacionin por edhe këto ditë mund të ketë nxënës që zgjedhin një nga shkollat profesionale në bashkinë Korçë. Për këta nxënës do të ketë rifutje sado që të jetë numri ?

Ekzekutivi S.Zguri: Ka afat deri në fund të dhjetorit.

Këshilltare A.Taho: Dhe pas kësaj mbledhje këta nxënës kanë mundësi që të rifuten?

Ekzekutivi S.Zguri:Po.

Këshilltar L.Malaveci: Këtë fundvit kemi një lajm të mirë nga bashkia Korçë për ritjen e buursave të nxënësve ekselente të gjimnazeve të qytetit nga njëzet mijë lek në muaj kjo shifër shkon në pesëdhjetë mijë lekë të vjetra në muaj. Unë do i shtroja një pyetje ekzekutivit po kategoritë e tjera që përfitojnë bursë a kanë një rritje dhe nëse po kur fillon kjo rritje?

Këshilltar E.Bregu: Mar shkas nga deklarimi i administratës që afati i mbledhjes të dokumentave është deri në fund të dhjetorit. Mos ndoshta do të ishte më mirë që kjo çështje të trajtohej pasi të mbaronte afati të ishin mbledhur të gjithë dokumentat dhe të merej një vendim total ?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Kjo çështje e bursave duhet miratuar brenda vitit, tani problemi është që këto lëvizje nga arsimi i përgjithshëm tek ai profesional duhet të ndodhin deri në fund të vitit .

Këshilltare A.Taho: Kryetar ne supozojmë sepse mund të jetë mbyllur transfermi mund të mos ketë më nxënës por mund të ketë nga ata që e bëjnë transferimin në minutat e fundit.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Kjo VKM-ja për bursat thotë që trajtohen me bursa ata që dorëzojnë deri në fund të muajit nëntor kurse për shkollat profesionale është deri në fund të muajit dhjetor. Ne bazohemi mbi atë cka na është dorëzuar.

Këshilltar E.Nexhipi: Diskutimi që po bëhet është si do jetë shtesa sepse 479 kanë plotësuar kriteret dhe po miratojmë këta 479 dhe çdo diskutim tjetër si mund të shtohet kjo listë se mund të jetë 1 rast ose mund të jenë 150 raste nuk na kushtëzon të miratojmë këta që kanë erdhur dhe pastaj kur të vijë lista tjetër. Ne sot miratojmë 479 listë dominale. Nuk më duket me vlerë diskutimi të plotësojmë njëherë 1 apo 100 të tjerë dhe pastaj të presim të miratohet. Për mua të vazhdojë me votimin e listës të ptopozuar po që se ka shtesa sipas ptopozimit të Zotit Lazjon apo të Anxhelës le të vijë në periudhë tjetër dhe mos penalizojmë këta 479 fëmijë.

Hidhet ne votim dhe miratohet

Vota PRO 34

Vota KUNDËR 1

Vota ABSTENIM 0

### **Pika 7 e rendit të ditës.**

**SIPAS KËRKESË TË SHOQËRISË "QËNDRA SPORTIVE KORÇË".SH.A. PËR THIRRJEN E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONERËVE PËR SHQYRTIMIN E MATERIALIT SI MË POSHTË;**

**PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË SHOQËRISË "QËNDRA SPORTIVE KORÇË" SH.A.**

Këshilltar A.Habip: Komisioni sipas kërkesës të Shoqërisë "Qendra Sportive Korçë" u njoh me materialin e dërguar nga drejtorja përkatëse lidhur me materialet e buxhetit të kësaj shoqërie, gjithë anëtarët e komisionit të buxhetit dhe financave të pranishëm morën informacion bënë pyetje dhe morën përgjigje nga drejtuesit e qendrës sportive. Mendoj që edhe këtë pikë të rendit të ditës ta kalojmë për miratim.

Hidhet ne votim dhe miratohet

Vota PRO 29

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 6

### **Pika 8 e rendit të ditës.**

**PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE E TË PERSONAVE TË TJERË TË ZGJEDHUR ORE TË EMËRUAR NË INSTITUCIONIN E BASHKISË DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË PËR VITIN 2024.**

Këshilltar E.Nexhip: Komisioni i ligjeve sipas programit të shpërndarë u mbledh diskutoi në lidhje me strukturën dhe nivelin e pagave, struktura e pagave në tërësi qëndron ajo që ka qënë me pak ndryshime. Vetëm në ndërrmarja e shërbimeve publike shtohen 7. Pjesa tjetër dhe niveli i pagave qëndron sipas nivelit të pagave që ka qënë gjatë vitit 2023. Diskutime pati në komision në lidhje me vendet kuptohet disa pozicione sic janë inxhinierët apo niveleve teknike ka akoma hapësirë.

Këshilltar D.Osmani: Përshëndetje, doja të pyesja pak cilat janë ndryshimet në nivelin e pagave dhe numrit të punojësve dhe arsytet?

Drejtorja juridike A.Dishnica: Për sa i përket nivelit të pagave nuk ka asnjë ndryshim krahasur me vendimin që është marrë në muajin gusht, niveli i pagave mbetet i njëjti si në vendimmarrjen paraardhëse por vendimi është futur për tu miratuar për procedurë sepse miratohet cdo vit së bashku me buxhetin ndërsa për sa i përket numrit të punojësve meqënëse kjo është pjesë e materiali të buxhetit ndoshta mund ta diskutojmë atje sepse numri i punojësve miratohet bashkë me buxhetin, në bashkinë e Korçës nuk ka punojës shtesë ka ndërrmarja e shërbimeve mbështetëse dhe arsimit ka vetëm 5 punojës shtesë, ku do jenë punojës për çerdhet 3 kujdestarë 1 sanitare dhe 1 ndihmës kuzhinier dhe ndërrmarja e shërbimeve publike ka 7 punonjës shtesë 1 manovrator, 1 punojës në sektorin e mekanikës dhe 5 punonjës provizorë në njësitë administrative. Tek institucionet e tjera mbetet përsëri i pandryshuar numri i punonjësve.

Këshilltar K.Pllaha: Përshëndetje, në fakt kam një kërkesë që më vjen nga grup trajnuerësh të klubit shumësportësh, pagat e tyre ata janë trajnuerë të moshave të rinjve e kam diskutuar në mbledhjen e komisionit kam marrë një përgjigje nga përfaqësuesi i klubit shumësportësh por mbase Zoti Kryetar ka një mundësi zgjidhje pasi ata paguhen aktualisht me një pagë nëntë mijë lekë në muaj dhe të gjithë e kemi të qartë që është shumë e ulët meqënëse në sportin e kemi prioritet dhe po investohet a mund të gjejmë një mekanizëm që të përmirësohet ky nivel pagash.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Tani kur thua dukshëm shumë i ulët diskutimi hyn në një fushë që është shumë relative domethënë kush do ishte shumë e madhe për ju, ndërkohë që sicu sqaruam nuk bëhet fjalë për pakpjesa kryesore e tyre janë të gjithë të punësuar kryesisht si mësues t5 edukimit fizik mbase edhe në profesione të tjera dhe kjo është një pagesë që e marrin për angazhimin me ekipet tona sportive. Është shumë relative ky diskutimi që kjo është pak sa do ishte shumë. Tani të të pyes unë ty cila do ishte një pagë e pranueshme dhe ti të me thuash një

shifër pyetja me pas do ishte pse kjo shifër. Nuk është se ne i kemi jashtë vëmëndjes por gjithmonë kërkesat janë më të mëdha se mundësitë.

Këshilltar L.Nako: Më ka erdhur një kërkesë nga Grupi Informacion i Orkestrës të Harqeve dhe ata e kishin për pjesën e pagave.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Të kalojmë më pas ju lutem në buxheti.

Hidhet ne votim dhe miratohet

Vota PRO 33

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 2

### **Pika 9 e rendit të ditës.**

#### **MBI MIRATIMIN E BUXHETIT VJETOR TË VITIT 2024 DHE PBA 2024-2026 TË BASHKISË KORÇË.**

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Po i jap fjalën kryetarit.

Kryetar i Bashkisë S.Filo: Padyshim që pika e radhës e rendit të ditës dhe materiali që do diskutohet është materiali më i rëndësishëm dhe vendimmarrja më e rëndësishme e këshillit të bashkisë pasi është materiali dhe vendimmarrja që do të orientojë të gjithë aktivitetin gjatë vitit 2024. Unë do përpiqem të bëj një paraqitje të përmbledhur të buxhetit me anën e disa shifrave kryesore dhe ajo që është me e rëndësishmja që dua ta ndaj dhe me ju dhe me qytetarët është cilat janë prioritetet tona dhe ajo që synojmë ne të mbështesim nëpërmjet këtij buxheti. Buxheti ka dy grupe atë të të ardhurave dhe atë të shpenzimeve në pjesën e të ardhurave buxheti përbëhet nga të ardhurat e veta që ne sigurojmë nga taksat dhe tarifat e mbledhim vetë si institucion që janë 55% e totalit të buxhetit në vlerën rreth 1.25 miliardë lekë, transferta e pakushtëzuar që ne na vjen nga qeveria qendrore e cila këtë vit është në masën 598 milion lekë dhe përbën 27% të buxhetit këtu më duhet të them që nga viti në vit kjo transfertë dhe angazhimi i qeverisë për të mbështetur nivelin lokal ka erdhur në rritje dhe vetëm para pak ditësh që ne kemi marrë dhe një pjesë tjetër të suportit financiar si pjesë e transfertës të pakushtëzuar që do të trajtohet në materiale të tjera gjatë muajit janar dhe transferta e kushtëzuar e cila na vjen përsëri nga qeveria por me destinacion këtë rradhë jo si transferta e pakushtëzuar, që për këtë vit është 408 milion lekë ose 18% e buxhetit. Në krahun e shpenzimeve buxheti është i ndarë në tre grupe kryesore: Shpenzime për personelin pagat dhe sigurimet shoqërore që janë në masën 935 milion lekë 41% e buxhetit, pjesa e shpenzimeve operative që është në masën 1 miliardë lekë 45 % por këtu në këtë grup futet dhe një pjesë e madhe e buxhetit që ne alokojmë tek ndërrmarja e shërbimeve publike për të realizuar më pas investime në qytet apo njësitë administrative, këtu përfshihet gjithashtu pagesa për realizimin e disa funksioneve kryesore sic është shërbimi i pastrimit, ndriçimi publik, gjelbërimi apo mbështetja që japim për shërbimin e transportit dhe grupi i fundit i shpenzimeve janë investimet që janë në masën 270 milion lekë ose 12% e buxhetit. Ky është buxheti i bashkisë në shifra të përgjithshme. Në listën e prioriteteve ose projekteve që unë do të



paraqes përveç buxhetit të bashkisë ju do të shihni që një pjesë e tyre mbështeten pjesërisht ose tërësisht me buxhet nga ana e qeverisë qendrore nëpërmjet fondit shqiptar të zhvillimit apo thirrjeve që hapin ministri të ndryshme kryesisht Ministria e Arsimit, Ministria e Financave, Ministria e Sipërmarrjes dhe Ministria e Buqësisë dhe një pjesë tjetër për suportin e realizimit të projekteve tona vjen nga donatorët, 4 janë drejtimet kryesore që ne si bashki do të mbështesin patjetër që ka dhe drejtime që unë do ti përmend por 4 janë kryesoret. Turizmi, buqësia, teknologjia dhe edukimi dhe këto 4 prioritetet lidhen me dy qëllime kryesore, e para është mbështetja e sektorëve ekonomik nëpërmjet të cilëve sigurojmë punësimin apo nxitjen e punësimit dhe këtu në mbështetjen e sektorit ekonomik kam parasysh turizmin edhe buqësinë, ndërkohe që mbështetja tjetër që ne duhet të krijojmë si bashki është krijimi i kushteve për të qëndruar këtu prandaj dhe dy prioritetet tona teknologjia dhe edukimi lidhen kryesisht me këtë. Tani për ta detajuar pak më shumë listën e prioritetëve tona po e filloj me prioritetin e parë që janë fëmijët edhe të rinjtë nëpërmjet projekteve tona ne synojmë tju krijojmë atyre mundësi më të mira për edukimin, mundësi për të pasur një jetë aktive jashtë shkollore, mundësi më të mira punësimi. Për sa i takon edukimit i cili është shumë i rëndësishëm grupi i parë i projekteve synon përmirësimin e infrastrukturës dhe këtu kemi lënë një buxhet prej 60 milion lekësh të reja për ndërhyrje rindërtimi në objektet e arsimit parauniversitar këtu projekte bashkëfinancohen edhe nga Ministria e Arsimit sic ishte dhe rindërtimi i Gjimnazit "Themistokli Gërmenji". Një fond tjetër prej 29 milion lekësh të reja do të dedikohet për mirëmbajtjen e gjithë objekteve të tjera të arsimit parauniversitar. Ambicia jonë është të kemi një arsim shumë cilësor dhe në dy projektet që unë do të përmend i pari është ndërtimi i një godine të re universitare në financim edhe nga Fondi Shqipëtar i Zhvillimit punimet do të fillojnë shumë shpejt dhe afati i përfundimit është qershori i vitit 2025 dhe në këtë infrastrukturë të kemi mundësi që të futim disa programe të reja studimore në bashkëpunim me universitete prestigjioze ndërkombëtare dhe projekti i dytë përsëri me ambicën për të pasur një cikël të mbyllur të një arsimit cilësor në qytetin tonë të dedikuar jo vetëm për të rinjtë edhe të rejat është hapja e një liceu francez është një projekt i cili do të jetë në vijim të një tradite historike që ne kemi mbi 105 vjetecare është dhe një angazhim i qeverisë shqiptare kryesisht edhe i kryeministrit dhe ka gjetur dhe mbështetjen e presidentit francez gjatë vizitës historike që ai pati në Shqipëri para pak muajsh. Grupi i dytë është ai i teknologjisë dhe kemi më shumë se tre vjet që flasim për këtë program të bashkisë të Korçës që synon ta shndërojë qytetin tonë në një qendër të teknologjisë sepse e shohim teknologjinë si një mundësi unike sidomos për të rinjtë që të kenë mundësi punësimi të mirëpaguara duke punuar për tregje ndërkombëtare do të alokojmë për këtë program 30 milion lekësh të reja me disa synime, synimi i parë është mbështetja e trajnimeve të ndryshme në disiplina të ndryshme që lidhen me teknologjinë, prandaj do të mbështesim të gjithë ata të rinj që do të bëhen pjesë e trajnimit në fushën e kodimit apo dhe disiplina të tjera, do mbështesim projektin e Korça City Academi që është një projekt unik që prej dy vitesh ndodh në Korçë ku mentore vijnë nga SHBA dhe trajtojnë një grup prej 100-120 të rinjsh nga Korça dhe nga qytetet e tjera, do të mbështesim trajnimet për fëmijët e grupmoshës nga 8-15 vjet në buxhetin e këtij viti kemi vënë një fond prej 6 milion lekësh të reja dhe duam që këtë shifër ta shumëfishojmë dhe të shkojmë në 500 fëmijë që do të trajnohen në kodim dhe robotikë do të mbështesim dhe krijimin e infrastrukturës ku këto trajnime do të ndodhin dhe e para është rindërtimi i bibliotekës të vogël sipas të njëjtit model që kemi tek biblioteka e re buxheti i lënë është 18 milion lekësh ndërkohe që një buxhet shtesë do e marrim nga qeveria zviceriane ndërkohe që do të hyjë në punë edhe godina e re e ish këshillit të qarkut që do të jetë një qendër arti kulture por edhe një qendër e re inovacioni ku ne do të kemi hapësira pune për kompanitë që duan të hapin degët e tyre në Korçë. Kemi vënë në funksion

edhe para pak ditësh edhe galerinë e artit dixhital është një projekt i cili synon të aftësojë një grup të rinjsh në fusha që lidhen me artin e videos të miksuar me teknologjinë. Kemi disa projekte shumë interesante përshembull vendosjen e laboratorëve të informatikës në disa shkolla dhe ne si bashki kemi alokuar një buxhet prej 5.8 milion lekësh që dhe ne të japim kontributin tonë në shtimin e këtyre laboratorëve, të mbështesim nëpër shkolla stafin që meret me pjesën e teknologjisë dhe projekti i fundit është një projekt për të cilën Korça është përzgjedhur si një qytet pilot në Shqipëri që lidhet me Smartcity ky është një projekt që do ju informoj më me detaje në vijim por e rëndësishme është që është përzgjedhur Korça si një qytet pilot. Ne duam të mbështesim të rinjtë që të kenë një jetë aktive jashtë skollore prandaj ne kemi mbështetur dhe do të mbështesim akoma me projekte siç është Qyteza e Fëmijëve, Zona sportive, Qëndër Rinore. Kemi dy aktivitet të cilat unë dua ti shtoj në të ardhmen që lidhen me krijimin e modeleve një nga gjërat që ne vuajmë si shoqëri në përgjithësi janë modelet që ne servirim si të sukseshme, dy projektet tona lidhen pikërisht me këtë gjë është rinshodhja e qelimit i tij është që talentet që marrin pjesë të kthehen në modele për gjithë komunitetin dhe projekti i dytë është projekti i bursave për gjimnazistët dhe kjo mbështetje këtë vit është më shumë se e dyfishuar. Grupi i dytë i prioriteteve që ne kemi është turizmi i cili është dhe do të jetë një sektor kryesor i zhvillimit të ekonomisë, Korça ka një potencial të jashtëzakonshëm për të qënë një destinacion i rëndësishëm turistik është i rëndësishëm sepse siguron të ardhura për bizneset. Sidat janë shtimi i produkteve turistike të ritim numrin e turistëve të huaj, ne do të fuksosohemi së bashku me partnerët tanë në infrastrukturën turistike do të fillojmë punën së bashku me Fondin Shqipëtar të Zhvillimit për qëndrën e eventeve tek vaskat e peshkut rrugës për në Drenovë dhe synimi ynë këtë vit është që Festa e Birrës këtë vit të zhvillohet tek kjo hapësirë. Ne para pak ditësh kemi firmosur investimin nga ana e Fondit Shqipëtar të Zhvillimit të rrugës nga Dardha në Sinicë e cila do synojë lidhjen e Bashkisë tonë e fshtatit Dardhë që është pjesë e bashkisë tonë me fshatrat e Devollit të sipërm për të pasur mundësi të organizojmë edhe atje paketa turistike, është duke ecur puna për aeroportin turistik dhe sportiv të Korçës i cili duhet të mbarojë në dhjetor të vitit 2024 ndërkohë që jemi duke ecur dhe me projektin e pistës të skive që unë e gjykoj një projekt shumë madhor infrastrukturor turistik kemi indetifikuar dhe afruar investitorë shumë serioz dhe tani jemi në dorë do të thoja në mënyrë figurative të kushteve të motetit që edhe ato janë shumë të rëndësishme për ushtrimin e këtij sporti. Prioritet tjetër zhvillimor është buqësia ku unë e kam përmbledhur pak duke futur zhvillimin rural dhe pyjet dhe këtu kemi disa sfida, sfida e parë është mbështetja e infrastrukturës brenda fshatrave ku kam parasysh infrastrukturën rrugore, ujësjellësat kemi lënë një fond në total 150 milion lekë të reja 50 milion buxheti i bashkisë dhe 100 milion buxheti i ndërrmarjes të shërbimeve publike për afsaltime rrugësh dhe materiale të tjera ndërtimore, e rëndësishme është përmirësimi i nfastrukturës në ndihmë të fermerëve me mirëmbajtjen e rreth 250 km kanaleve vaditës dhe kullues. Kemi një projekt shumë të rëndësishëm që është ndërtimi i një qëndre të ekselencës të buqësisë edhe blegtorisë si një qëndër që ne do të implementojmë konkretisht modelet me të sukseshme të fermave buqësore dhe blegtoriale dhe me pas këto modele pasi ti shohim në praktikë do ja u japim si modele të gatshme fermerëve për ti replikuar. Për sa i takon pyjeve ne në buxhetin e këtij viti kemi lënë një fond prej 12 milion lekësh të reja të siguruara nga të ardhurat që ne marrim nga pyjet për tu rikthyer në investimeve kryesisht të reja në masivet pyjore. Infrastruktura është shumë e rëndësishme dhe e përmenda buxhetin që ne kemi për infrastrukturën këtu do të vecoja një projekt tjetër që është termoizolimi i banesave ku kemi lënë një buxhet prej 10 milion lekësh të reja në këtë projekt kemi filluar me një objekt që është pallati i Agimit po e quaj sepse kështu njihet me emrin në qytet, ndërkohë që gjatë muajve të parë të vitit që vjen do të fillojmë ndërhyrjen në rreth 10-12

pallate të tjera në disa lagje si 15,16 dhe do të jemi me pas në diskutim edhe me donatorë të tjerë që këtë projekt ta zhvillojmë më tepër. Ne gjithashtu nuk do të lemë mënjatë edhe disa kategori që janë në nevojë ku unë po përmend disa : transporti urban falas për pensionistët në masën 10 milion lekë të reja janë rreth 15 mijë përfitues, qendra ditore për të moshuarit dhe fëmijët, projekti i përmirësimit të kushteve të banimit i cili është një projekt që e kemi realizuar në katër vitet e fundit bashkëfinancim me Ministrinë e Financave buxheti i lënë për këtë projekt është 10 milion lekë të reja, kemi projektet të tjera siç është qendra e emergjencës. Grupi tjetër i prioritetëve tona lidhet me artin dhe kulturën në të cilë Korça ka hedhur gurë dhe themel në artin e kulturës Shqiptare, drejtimi i parë është infrastruktura e artit dhe kulturës përveç infrastrukturës shumë e rëndësishme është dhe mbështetja që je japim për kalendarin e aktiviteteve artistike dhe kulturore, lista e aktiviteteve ka parasysh tre kritere kryesore të jenë aktivitete kulturore gjithëpërfshirëse, e dyta kombinojmë kapacitete lokale me kapacitete që vijnë nga jashtë Korçës si të ftuar në aktivitetet që ne organizojmë, parimi i tretë që ne kemi pasur është të jenë në funksion të turizmit pra një pjesë e tyre të ndiqen edhe nga vizitorë, me pas vjen sporti dhe këtu mbështetja jonë a shkuar në tre drejtime në infrastrukturën sportive mirëmbajtja, ndërtimi i stadiumit të ri dhe rikonstruksioni i pallatit të sportit, rreth infrastrukturës mbështetëse dhe dy qëllime të tjera e para është masimizimi i sportit dhe këtu jemi bashkë me Komitetin Olimpik Shqiptar në projektin e masimizimit të sportit në shkollat dhe mbështetja e dytë vjen për ekipet zinxhir akademitë e ndryshme sportive në disiplinat e ndryshme sportive dhe për sportin elitare pra për ekipet e para nëqoftëse dëshirojmë të jemi të parët në fushën e sportit duhet të investojmë në infrastrukturë. Buxheti mbështet gjithashtu shërbimin e pastrimit, e ndriçimit publik, i gjelbërimit, i mirëmbajtjes të varrezave janë të gjitha shërbime shumë të rëndësishme, për ta përmbyllur dua t'ju jap një informacion për projektet madhore, projekti i gazifikimit është projekt madhor që do të mbyllë infrastrukturën e qytetit dhe është një projekt i cili në këndvështrimin tim po ecen me ritme shumë të mira, kompania që do të angazhohet në realizimin e këtij projekti e cila ka angazhuar dy kompani konsulence të cilat njëra po bën studimin e fleksibilitetit teknik që pritet të përmbillet në muaj e parë të vitit 2024 dhe kompania tjetër fleksibilitetin ekonomik, objektivi është që në vitin 2025 ne të lidhim abonentët e parë me gaz, mund të jenë abonentë industriale, familjarë. Projekti i dytë madhor ka qënë stadiumi dhe poli ekonomik rreth tij këtë e shpjegova nuk po ndalem është një projekt i cili padyshim do të realizohet dhe shpresoj shumë që fillimi i punimeve të jetë brenda këtij viti. Projekti i polit të jugut që e kemi quajtur ne që janë grupi i projekteve që do të ndodhin në hapësirën ndërmjet Drenovës, Boboshticës dhe Qatromit si hapësirë gjeografike dhe ky projekt është duke ecur në disa komponentë të tij dhe shumë shpejt presim të fillojë rikonstruksionin e qendrës të fshatit Drenovë, do të fillojnë punimet për ndërtimin e qendrës të eventeve dhe do të jetë një projekt që do të ndodhe në mënyrë të përshkallëzuar. Ky ishte prezantimi im për buxhetin e vitit 2024, buxheti është shumë i detajuar materiali është shumë i detajuar por unë besoj që në një prezantim të parë detyra ime ishte t'ju bëja prezente prioritetet tona, sektorët tanë prioritarë aty ku ne do të vemë theksin dhe në fund fare dua t'ju kërkoj mbështetjen për ta miratuar këtë buxhet dhe për t'ju çelur rrugën me pas realizimit të këtyre projekteve, shumë faleminderit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit Kryetar për këtë detajim të shtyllave kryesore të prioritetëve dhe sfidave që do të përballet buxheti 2024 dhe PBA 2024-2026. Tani është rradha për ti dhënë fjalën komisionit të ekonomisë dhe financave.

Këshilltar E.Bregu: Meqënëse pas fjalës të kryetarit priten të zhvillohen diskutime të gjata dhe mendoj se do marrë shumë kohë, unë propozoj që të bëjmë pushim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju faleminderit për sygjerimin por duke qënë që një pjesë e jona e këshilltarëve nu kanë mundësi për tu larguar sepse mbledhja ashtu si thatë dhe ju do shkojë gjatë dhe nëqoftëse ne lejojmë të bëhet dhe pushimi në mes do shkojë akoma më gjatë unë mendoj të vazhdojmë me komisionin dhe me pas të administrojmë pyetjet që do të vijnë nga këshilltarët duke vënë në vëmendje për të qënë me racionale në kohë do ju jepet fjala vetëm një herë duke grumbulluar të gjitha pyetjet që duhet të adresojnë në ekzekutivi.

Këshilltar D.Osmari: Ku është kjo rregullore që këshilltarët duhet ta marrin vetëm një herë fjalën?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Për të njëjtë pikë të rendit të ditës ka të drejtë të bëjë vetëm një herë pyetje domethëne ju mund të bëni disa pyetje por vetëm një herë do e merni fjalën.

Këshilltar D.Osmari: Zonja Kryetare pyetjet lindin edhe gjatë diskutimeve kështu që kjo po thoni është heqje e fjalës.

Këshilltare A.Përmeti: Komisioni i financave buxhetit dhe ekonomisë u mbledh në datën 27 kishte dhe pjesëmarrës përveç komisionit këshilltarë të tjerë u bë një diskutim rreth dy orë ku këshilltarët bënë pyetje dhe u njohën në mënyrë të detajuar me pjesën e planifikimit të buxhetit të vitit 2024 por edhe PBA për 3 vitesepse nuk jemi vetëm për buxhetin por jemi dhe për pjesën e PBA-së. Në lidhje me atë që ne diskutuam ishte pjesa e detajuar e të ardhurave dhe nga sigurohen ato, një detajim i vogël që mund të duhet edhe për kolegët në vazhdim është që planifikimi bëhet mbi kapacitetet sipas ligjit pavarësisht se sa shfrytëzohen këto kapacitete në drejtim të burimit të të ardhurave, edhe në pjesën e borxhit të keq sepse ju mund të shihni që realizimi dhe planifikimi kanë ndryshime ka një ligj që lejon deri në 18 muaj të përfshirjes të tij pra kjo është një nga shpjegimet që u dha gjatë aktivitetit, ajo që ne vume re ishte që buxheti mbështet dhe parashikon burimet kryesore që ka bashkia Korçë dhe banorët e saj, gjithashtu kishte një vëmendje të shtuar për kujdesin e shtresave në nevojë, ndaj pensionistëve si dhe gjallërimin e jetës kulturore me anë të aktiviteteve të ndryshme duke mbështetur programe të caktuara gjatë gjithë vitit. Ajo që vlerësohet nga ana teknike është që bashkia Korçë ka hyrë në një program ku ana financiare e bën më të lehtë menaxhimin financiarisht të aktiviteteve sepse ka 11 programe ku ti mund ti ndjekësh në mënyrë të vazhdueshme. U vlerësua dhe krijimi i njësisë statistikore e cila do të masë performancën që ishte një pikë e vlerësuar më parë dhe morëm përgjigje që është krijuar e cila do të mundësojë që nga ana statistikore bashkia të mund të ndjekë performancën por ka edhe investim që lidhet me teknologjinë e informacionit për vetë strukturat administruese të bashkisë. Unë do të ndalem pak në disa elemente që vazhdimisht njerëzit na i kanë ngritur gjatë takimeve, vlerësoj që është përfshirë në buxhet dhe e vlerësuam dhe në komision pjesa e sinjalistikës dhe e rrugëve ku është planifikuar një buxhet prej 12 milion lekësh të reja, ajo e kujdesit ndaj kafshëve ku është planifikuar rreth 1.2 milion lekë të reja për këtë pjesën e kujdesit ndaj qenëve sterilizimin por na u tha që është parashikuar në buxhetim edhe një qëndër për kujdesin ditor të tyre e cila aktualisht është në tenderim. Një element tjetër shumë i rëndësishëm është pjesa e zhvillimit ekonomik dhe të turizmit dhe ashtu si e tha dhe kryetari është e vërtetë që nëqoftëse ne fokusohemi dhe në atë për të cilën kemi vlerë të shtuar

komplet pjesa tjetër e zinxhirit ekonomik do ketë një vlerë të shtuar sepse jo vetëm sektorët e turizmit por edhe sektorë të tjerë përfitojnë sidomos tregetia apo shërbime të tjera në qytet dhe kjo e bën zonën tonë të vecantë dhe unike dhe ne duhet ta mbajmë këtë unicitet dhe do të krijojë një vlerë të shtuar në vazhdimësi. Unë kam një pyetje në lidhje me investimet në lidhje me zhvillimin ekonomik dhe vendor, fondi në dispozicion për investimet është rreth 19 milion e 600 mijë lekë të reja dhe një nga këto është një investim për instalacionin dixhital dhe do të doja nga zoti kryetar një sqarim sesi është menduar kjo?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Po flet si kryetare komisioni.

Këshilltar D.Osmeni: Povedura do bëhet ashtu si doni ju apo ashtu si është shkruar ?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ajo po flet në lidhje me atë çka u tha në komision komentet dhe pyetjet që janë ngritur brenda komisionit, unë do ja u jap fjalën edhe anëtarëve të tjerë të komisionit.

Këshilltare A.Përmeti: Një element tjetër që u diskutua nga komisioni ishte dhe pjesa e shpenzimeve në lidhje me energjinë elektrike e cila është një zë i rëndësishëm dhe u diskutua sesi mund të ishte mundësia që bashkia të shikonte mundësi për energji të tjera të rinovueshme për objektet që janë pronë e saj, gjithashtu u vlerësua që buxheti në planin e tij është me rritje por ajo që është e rëndësishme që pjesa e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat të mbulojnë një pjesë kryesore do të thotë që bashkia është retabël në administrimin e të ardhurave të saj dhe ndarjen e saj të shpenzimeve. Ne si komision pas diskutimit rreth dy orë dhe sqarimit të gjitha aktiviteteve që kishte buxheti morëm vendimin për ta kaluar për miratim sepse ky buxhet është një buxhet i cili mbështet shërbimin dhe vjen në ndihmë të komplet zhvillimit ekonomik social kulturor dhe artistik të banorëve të bashkisë Korçë.

Sekretare e Këshillit E.Naçi: Mund të them diçka e kisha në lidhje me debatin për kryetarin e komisionit, në rregulloret e përcaktuar kryetari i komisionit i përhershëm apo i autorizuari prej tij që ka rradhën të raportojë në mbledhjen e këshillit i jepet mundësia nga kryesuesi i mbledhjes të hapë debatin për mocionin çështje për shqyrtim sipas rendit të ditës.

Këshilltar D.Osmeni: Dakort pra, e para e punës unë jam pjesë e komisionit së bashku me Alketën dhe ne nuk jemi vënë në dijeni njëherë, kryetari është aktualisht është në sallë mund ta prezantonte vetë e dyta dhe nëqoftëse delegonte të na i vinte ne si komision sepse tani këto nuk mund të bëhen kështu dua unë edhe, rregulli është rregull.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Atëherë fjala është për ju meqënëse jeni anëtar i këtij komisioni.

Këshilltar D.Osmeni: Si pjesë e komisionit unë po bëj një përmbledhje të situatës të këtij buxheti edhe më pas mendoj që mirë është që ne të vazhdojmë me pyetjet sepse ajo është më e rëndësishmja. tani edhe në komision e ngritëm problemin që një material si ai i vitit që po vjen të futet në rend dite me 9 apo 10 pika në rregulloret është që maksimumi duhet të kishte 5 pika dhe që këtu besoj nga ju Zonja Kryetare apo edhe nga sekretaria është shkelje sepse në çdo moment na i vini ne në dukje ato shkeljet që bëjmë ne sipas jush gjithmonë. Cila është arsyeja që janë futur gjithë këto pika ku sot u shtua prapë një pikë sepse ne të gjithë këtu e dëgjuam me vëndje

dhe prezantimin e kryetarit për buxhetin në respekt të fjalës të tij por tani e para kërkuam një pesë minutëshe pushim nuk na dhe e dyta më thuaj pse e keni shkelur rregulloren.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Hap fjalën për pyetje për këshilltarët drejtuar ekzekutivit.

Këshilltar E.Bregu: Së pari dua të falenderoj Kryetarin e Bashkisë për urimet që na kishte dërguar nëpërmjet kartolinave për festat e fundvitit duke i konsideruar si një qasje për një bashkëpunim midis kryetarit të bashkisë, administratës dhe këshillit. Ndaj doja ti uroja kryetarit, administratës dhe të gjithë kolegëve këshilltarë, Gëzuar Festat e Fundvitit!

Së dyti në vijim të kësaj qasje për bashkëpunim midis kryetarit të bashkisë, ekzekutivit dhe këshilltarëve dua ti tërheq vëmendjen kryetarit të bashkisë dhe kryetares të këshillit që fakti që kanë vendosur rend dite më shumë se pesë pika për ditën e sotme e ve në risk vendimmarrjen dhe nuk ka për borxh askush që të vendos vendimet e këshillit në risk, kjo është një përgjegjësi shumë e madhe dhe nuk e kuptoj si e merni guximin të vendosni këshillin në këtë risk. Të gjithë të zgjedhurit këtu në këshill janë për të dhënë kontributin e tyre për mirëqeverisjen ndaj në këto kushte është shumë e vështirë që ne të pranojmë të lejojmë shkelje të vazhdueshme të rregullores të procedurave nga ana e këshillit, gjithashtu në momentin e diskutimit për miratimin e paketës fiskale...

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem keni pyetje në lidhje me materialin parashtrimin lëreni për më vonë dhe po ju vë dhe unë diçka në vëmendje që rregullorja është rregullore por ka dhe materiale të cilat duhet të miratohen duke zbatuar ligjin që do të thotë materiale të cilat kanë afate kohore për tu miratuar kështu që nuk mendoj që dhe materialet e shtuara të kenë bërë problem për kohëzgjatjen e mbledhjes të këshillit. Tani po kaloj edhe njëherë duke ju drejtuar a keni pyetje në lidhje me projektbuxhetin?

Këshilltar E.Bregu: Në vijim të procedurës pyetja i drejtohet komisionit të financës, duke pasur parasysh që në komision janë bërë diskutime është pyetur administrata janë kthyer përgjigje. Unë doja të dija nëse janë shënuar në proceverbale këto diskutime që ne të dimë ta kemi të bazuar diskutimin mos dalim para ndonjë fakti nëse e kemi bërë këtë diskutim dhe e kemi marrë këtë përgjigje apo jo. Cilat çështje janë trajtuar aty pyetjet dhe përgjigjet?

Këshilltar D.Osmeni: Përshëndetje të gjithëve, atëherë unë kam disa pyetje. Në rradhë të parë doja të pyesja sepse nuk e kam marrë këtë përgjigje në komision nga ana e ekzekutivit. Në momentin që ky buxhet është prezantuar a janë mbajtur akte normative nga qytetarët, ka patur propozime konkrete dhe nëqoftëse po cilat?

Në lidhje me punojësit dhe rritjen e punojësve të bashkisë i cili mesa kam parë çdo vit vjen duke u rritur, unë dua të pyes një punojës bashkie në këtë nivel mbulon dhe shërben sa qytetarëve? Në lidhje me planin dhe pritshëritë e vitit 2023 dhe me planin e vitit 2024 unë shikoj një mosrespektim të mosrealizimit të vitit 2023 me atë që ne presim në vitin 2024, pse është ky mosrealizim për vitin 2023 në krahasim me planin e vitit 2023?

Këshilltare S.Dinellari: Përshëndetje së pari vlerësoj punën që është bërë në lidhje me hartimin e projektbuxhetit dhe pjesëmarrjen e drejtorive përkatëse në lidhje me shpenzimet apo të ardhurave që atyre ju duhen për të realizuar shpenzimet përkatëse. Pyetja ime është e përgjithshme në

mënyrë që më pas ta lidhim me komentimin që do të ngelet në fund. A kemi një numër të saktë të popullsisë në qytetin e Korçës dhe të Qarkut sepse nga analiza swot është manipuluar me indikatorët, treguesit nuk maten vetëm me adoleshencën 0-24 por me moshën e punës dhe këtë e lidh përsëri me të ardhurat dhe shpenzimet që ka bashkia për të hartuar projektbuxhetin?

Këshilltar K.Pllaha: Unë po e nis nga mbledhja e të ardhurave që ka dy taksa që zënë një peshë të rëndësishme, taksa për tokën buqësore e cila parashikohet në vlerën 57 milion lekë por nga këto një masë e konsiderueshme janë debitorë 33 milion. Ka ndonjë masë shtrënguese për mbledhjen e këtyre debitorëve për tokën buqësore? Nga ana tjetër për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga tatimet e reja në vitin 2023 ishte parashikuar 222 milion ndërkohë që janë mbledhur vetë gjysma e kësaj dhe në vitin 2024 plani është edhe më i lartë se kaq është 280 milion, dua të di si i parashikoni të mbledhni këto të ardhura. Si parashikoni që do ketë akoma më shumë rritje keni një plan të ri të shtimit të zonave të ndërtimit apo diçka tjetër ?

Ndërkohë përse i përket shpenzimeve dhe duke mar shkas nga prezantimi i Zotit Kryetar më vjen mirë që e nisët nga projektet tuaja për fëmijët dhe të rinjtë, është parashikuar ndonjë investim për krijimin e këndeve publike të lojrave në lulishtet e qytetit ose të paktën rindostruksionin e atyre që janë ndërtuar më parë?

Për sa i përket teknologjisë e shoh që është një prioritet dhe më vjen mirë por a ka ndonjë lehtësim për fëmijët familjet e të cilëve janë në nevojë për ti përfituar këto trajnime totalisht falas?

Për shërbimin social e keni menduar ndërtimin e banesave të reja për të pastrehët që mund të jepen me qera sociale?

Edhe një pyetje që nuk e kam kuptuar në materialin që na është dhënë në dispozicion, ka një pagesë prej 37 milion lekësh të reja në vit për landfillin e mbetjeve është pjesë e ndonjë kontrate sepse nuk e kuptoj ?

Kryetar i Bashkisë S.Filo: Kontrata e pastrimit parashikon pastrimin e një pjese të rrugëve të qytetit grumbullimin e mbetjeve dhe transportin deri në landfill, për depozitimin në landfill ne kemi kontratë me kompaninë që operon landfilli.

Këshilltar K.Pllaha: Sa mendohet të investohet tek poli i jugut që përmendët ose tek qendra e eventeve?

Këshilltar L.Petri: Pyetjet e mia do konsistojnë në tre shtylla në turizmi, mjedisi dhe kultura sepse tek këto fusha unë jam në komision. Në lidhje me turizmin ka planifikuar ky buxhet për mbështetjen e turizmit të natyrës dhe kulturës por kryesisht për turizmin e natyrës dhe për përfshirjen e zonave të thella rurale. Tek ky buxhet u përmend nga zoti kryetar që për pensionistët është falas dhe është për tu vlerësuar por për turistët është menduar që do të rritet rjeti i transportit urban si në mbulim gjeografik ashtu edhe në fashën e orareve. Në lidhje me infrastrukturën e fshatrave vë re një mosrespektim të zonave buferike siç është kisha e "Shën Ilias" në Voskopojë ku u bënë ndërtime të papranueshme për mendimin tim, a është menduar nga ekipi i ekzekutivit që të planifikohet dhe respektohet një studim i mirëfilltë i zonave që janë me një gravitet të rëndësishëm të vlerave natyrore. Për qentë e braktisur unë personalisht nuk pashë ndonjë material është bërë ndonjë studim për këtë dhe të dihet se sa do shkojë kostoja?

Për turizmin e eventeve Fondi Shqiptar u përmend nga zoti kryetar por Fondi Shqiptar martenitetin e ktheu në hotel dhe nuk është një institucion për tu marë shembull sepse për mua

po kthehet në makth për qytetarët. Në lidhje me turizmin është planifikuar një strukturë emergjence sepse me aq dijeni sa kam unë kur e bën prioritet një zonë të caktuar për turizmin është e dorës së parë rëndësia që ti të kesh një strukturë emergjence sepse një turist në majë të Cardhakut i thyhet këmba tjetrit dhe ti nuk e sjell dot në spital, propozimi im është që kjo strukturë mund të fillojë me dy persona personel dhe me pas plotësohet me vullnetarë. Për Vithkuqin i cili është në ditë të hallit dhe është një fshat me një trashëgimi të jashtëzakonshme kulturore dhe sot nuk kanë ujë të pijshëm në shtëpitë e tyre, çfarë keni planifikuar me buxhetin tuaj?

Në lidhje me mjedisin shkëlqesitë e Azerbajxhanit por dhe ju zoti kryetar besoj duhet ta dini që në Evropë gazi metan po rritet çmimi po rritet me një përqindje të konsiderueshme dhe pse nuk merret parasysh energjia alternative siç është enegjia diellore. Për infrastrukturën mesimore ju përmendet që do të ndërtoni disa shkolla dhe përmendet edhe shkollën "Themistoli Gërmenji" por nuk më rezulto që atje të jenë vënë panele diellore. Në lidhje me mjedisin urban konstatohet nga një shumëllojshmëri qytetarët që po shkatërohen lagjet historike është planifikuar në buxhet ndonjë studim i mirëfilltë që në këto lagje historike të mund të respektohet hapësira e obereve dhe mos shkatërohet. U përmend pista e skive por ne kemi aq pak shkollë sa të shikojmë që nuk po bie më dëborë si mund të vazhdohet me kaq këmbulje për një projekt që do të sillte mjaft të ardhura dhe do të zhvillonte turizmin por në momentin që koha është e tillë kostoja për ta prodhuar borën vetë rritet shumë. Po e mbyll me kulturën nuk me rezulton që të jetë planifikuar diçka në lidhje me Asdrenin a është menduar diçka për këtë figurë kaq emblematike dhe ne nuk kemi një objekt nuk kemi një program ku mund të frymëzohemi nga kjo figurë. Në lidhje me artin, arti për mua është brymë, unë di që është bërë një letër dhe është kërkuar nga formacioni i harqeve për një rritje të shpërblimit është vënë në dijeni nënkryetarja dhe kryetari i këshillit. Pse nuk është kthyer përgjigje për këtë letër dhe pse ky shpërblim për ta ka ngelur në 5 mijë e 900 lekë dhe ju propozoni 8 mijë lekë ku ndërkohë Shkodra dhe Elbasani marin nga 20 mijë lekë ku ky formacion ka marë çmime të jashtëzakonshme në nivel kombëtar?

Këshilltari A.Zheku: Kam dy pyetje të shkurtra njëra në lidhje me moshën e tretë një moshëmjaft e ndjeshme ku të gjithë jemi dëshmitarë rritjes të numrit të kësaj moshe përveç fondit të parashikuar dhe ngritjes të qëndrave ditore, çfarë është menduar nga ana juaj për atë grupmoshë për ata persona të cilët kanë pamundësi për të levizur dhe janë të vetmuar, a është menduar për ngritjen e një qëndre përveç asaj private pasi çmimet janë të larta në lidhje me pensionin që marin dhe kapacitetin e ka të vogël ajo qëndër dhe ka erdhur koha që vërtet bashkia duhet të mendojë për këtë kategori. E dyta në lidhje me trajtimin e katërputroshëve shqetësime të frikshme nga gjithë qytetarët, fëmijët nga pyetjet e ekzekutivit në komision që ne u bëmë është parashikuar një shumë u dhe relatorja e komisionit të financës e parashtrori dhe shuma e parashikuar aty nga sqarimi që ne morëm është vetëm për rehabilitimin e një qëndre të trajtimit të katërputroshëve por vetëm merej në konsideratë matrikulli me sa morëm sqarim nuk mendoj që kjo do të jetë zgjidhje por do të duhet strehimi i tyre dhe më pas aty duhet të jenë persona të specializuar Ky është një shqetësim i madh nga ana e qytetarëve dhe do duhet të merej në konsideratë sepse nuk është ngritur sot nga ana ime por është prej muajsh ose prej vitesh. Pyetja tjetër zgjedhja e pallatit për termoizolim cilat janë kriteret sepse ju thatë që edhe këtë vit parashikohet një numër relativisht mendoj i vogël në krahasim me ata që kanë nevojë.



Këshilltar E.Fejzullah: Faleminderit Zonja Kryetare pyetja ime e parë ka të bëjë me buqësinë, ku problemet që kanë qytetarët janë shitja e produktit siguria nga kushtet atmosferike. A është menduar një mbështetje në këto problematika?

Pyetja e dytë është për sa i përket fondit pyjor a keni një studim sesa duhet të investohet për të rikuperuar këto problematika?

Tek sporti do doja të dija që dhe investimet në sport janë menduar të deversifikohen në të gjitha sportet dhe jo vetëm të fokusuara tek atje ku mendohet që jemi kompetitiv si football ose vojebolli. Për sa i përket sinjalistikës a është menduar një rifreskim i sinjalistikës horizontale dhe vertikale të qytetit dhe të mendohet që kjo sinjalistikë ti rezistojë kohës dhe të jetë sa më efiçiente?

Këshilltar L.Malaveci: Duke qënë se jam pjesë e komisionit të arsimit dhe sportit dua një informacion nga ekzekutivi për sa i përket bursave për nxënësit ekselente dhe kategorive të tjera. Kjo rritje që ka kaluar në shifrën 5 mijë lekë të reja ku do të meret nga nxënësit, a ka filluar?

Këshilltar D.Osmani: Doja t'ju pyesja në lidhje me ngrohjen nëpër shkolla dhe kopshtet e qytetit sipas ligjit mesa informacion kam ato janë që në nëntor deri në mars por problematika që ata kanë në gjithë qytetin apo edhe në fshat është një problem që kanë dhe hasin fëmijët nëpër kopshte dhe shkolla. A është marë ndonjë masë dhe a është projektuar diçka nga bashkia për vitin 2024?

Në lidhje me termoizolimimin që kryetari na i prezantoi në komision na u tha nga ekzekutivi që ai 10 milionshi i planifikuar është viti i disatë që nuk shpenzohet nga bashkia për arsye sepse ai duhet të jetë me pjesmarrje që një pjesë e vendos bashkia dhe një pjesë e vendos vetë banori. Tani në lidhje me këtë si do zgjidhet në 2024 sepse përderisa nuk është zgjedhur deri në fund të 2023 sepse vërtet e keni alokuar këtë fond dhe mendoni ta miratoni në buxhet sot por unë mendoj që ai do jetë i përealizuar përsëri përsëri për 2024 nëqoftëse nuk mendohet diçka ndryshe.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, atëherë hapim fjalën për përgjigje ndaj pyetjeve të ndërtuara nga këshilltarë, po bëj një parantezë këtu një koment paraprak unë di që në të gjitha komisionet mblidhen mbahet një proceverbali dhe proceverbali në fund të takimit firmoset nga këshilltarët pjesmarrës në mbledhjet e komisionit por edhe ata që nuk janë pjesë e komisionit por kanë marë pjesë. Unë besoj që Zoti Bregu e ka marë fjalën në komision ka ndërtuar pyetje ka bërë komente në lidhje me buxhetin dhe besoj që mund të jetë administruar nga mbajtësi i proceverbali dhe mund ti vihet në dispozicion.

Këshilltar A.Habip: Komisioni ka proceduar në rradhë të parë me bazën ligjore me dokumentacionin dhe pyetjet kanë që lidhur me përmbajtjen e materialit, materiali ka qënë i bollshëm drejtues të ekekutivit kanë qënë prezent kanë dhënë përgjigjet e duhura por nuk është detajuar çdo pyetje dhe përgjigjet që janë marë atje. Kushdo nga këshilltarët që kanë qënë atje ka bërë pyetjen e vet është sqaruar nga përfaqësuesit e ekzekutivit. Kanë qënë rreth dy orë që janë bërë pyetje janë dhënë dhe shpjegime.

Këshilltar E.Bregu: Por nuk janë mbajtur të rregjistruara pyetjet dhe përgjigjet.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Po ja u vemë në dispozicion proceverbalin shikojeni me kujdes dhe lexojeni.

Sekretare e Këshillit E.Naçi: Këshilltari Bregu ishte i pranishëm në mbledhjen e komisionit dhe nuk e di tani ku është qëllimi që janë mbajtur pyetjet apo jo. Procesverbalet mbahen nga komisioni nga sekretari i komisionit edhe Zoti Elvini ishte prezent dhe bëri pyetjet dhe mori përgjigjet.

Këshilltar I.Bode: Pyetja ime është për kolegët këshilltar të shumicës, kaq mirë e kanë përthithur këtë material kaq voluminoz me shifra sa nuk dëgjuam ndonjë pyetje nga ana e tyre?

Këshilltar E.Nexhip: Nuk kishim pyetje sepse është një buxhet i konsoliduar prej vitesh është shpërndarë në kohë, ekzekutivi ka qënë i hapur për pyetje direkte jo vetëm në komisione unë gati përditë kam pyetur për materialet dhe kam marrë përgjigje. Tani nëqoftëse duhet të bëjmë show këtu bëjmë show në transmetim jemi secili ka mednimet e veta politike por të ngacmojmë një grup tjetër këshilltarësh pse pyesni pse nuk pyesni nuk më duket korekte.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Pas zotit Nexhip nuk do e jap më fjalën për pyetje që nxisin provokim mes këshilltarëve dhe krijojnë debat sepse nuk zgjidhim asgjë me debat.

Këshilltar E.Bregu: Unë do e bëj një pyetje dhe ju lutem mos prishni seancën dhe këtë pikë të rendit të ditët që po diskutojmë e cila është shumë e rëndësishme.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Të lutem ta kam dhënë fjalën, tani është radha për kryetarin e bashkisë, respekto rregulloren.

Këshilltar E.Bregu: Tani Erjoni na u përgjigj që kemi patur mundësi çdo ditë të bëjmë pyetje dhe ai vet ka bërë pyetje në administratë dhe komisione, ne pyetje kemi patur të drejtë ti bëjmë vetëm në komision nuk mund të bëjmë cdo ditë, kështu që ky është një manipulim.

Sekretare e Këshillit E.Naçi: Të lutem për procedurë nuk lejohet kundër replikë. Pas replikës nuk ka kundër replikë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Fjala për Kryetarin e Bashkisë.

Këshilltar D.Osmani: Zonja Kryetare unë nuk doja të ndërhyja por këshilltari Erjon Nexhipi nuk është kryetari i grupit që dha përgjigjen, është e disata herë që kur flasim ne si këshilltar opozite na ndërpritet fjala nuk na lejohet.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Fjala për Kryetarin e Bashkisë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Shumë faleminderit, për pyetjet unë besoj që për një pjesë do të përgjigjem unë kurse për një pjesë stafi i cili është prezent pasi ka informacion më të detajuar. Për sa i takon marrjes parasysh në buxhet të kërkesave të banorëve që kanë dalë nga takimet e buxhetimit me pjesmarrje patjetër që janë marrë parasysh dhe në këndvështrimin tim një buxhet për të qënë i mirë dhe i balancuar duhen marrë parasysh edhe kërkesat e banorëve dhe prioritetet

zhvillimore të administratës të bashkisë, patjetër që kërkesat për infrastrukturën rrugore janë kërkesat e banorëve edhe në qytet edhe në fshat. Investimet për rrjetin e kanaleve kullues vaditës patjetër që janë kërkesa të banorëve, çdo element i buxhetit ka brenda edhe në një masë të caktuar edhe kërkesat e banorëve edhe sesi e sheh bashkia të ardhmen e qytetit. Për sa i takon planit të realizimit të të ardhurave në vitin 2023 besoj Soni mund të japë një shpjegim për pyetjen.

Drejtori i të ardhurave dhe taksave vendore S.Prifti: Këtë pikë ne e diskutuam dhe në komision dhe e sqaruam që ne planifikojmë në bazë të kapaciteteve dhe mbi bazën e informacioneve që na vijnë nga drejtoritë e tjera. Puna që bëhet gjatë vitit pasqyrohet ndërkohe që analizë të detajuar ne bëjmë analizë të buxhetit që e kemi nxjere dhe atje nxjerrim dhe defektet dhe ku ka caluar mosrealizimi i planit.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ishte një pyetje tjetër që lidhet përsëri me drejtorinë e të ardhurave numri i popullsisë, mënyra sesi ne i mbledhim të ardhurat në raport me popullsinë dhe familjen. Kurse numri i punojësve e kemi në material është i planifikuar 1311 në plan 1096 në fakt. Tani numri i popullsisë ne kemi rregjistrin e gjëndjes civile dhe jemi 130 mijë banorë në bashkinë e Korçës 87 mijë në qytet në bazë të rregjistrin në bazë të censusit kur të dalin të dhënat në qershor, nuk ka asnjë shifër zyrtare të dhënat dalin në qershor. Pyetja tjetër ishte mënyra sesi ne mbledhim tarifatat nga familjarët në raport me popullsinë.

Drejtori i të ardhurave dhe taksave vendore S.Prifti: Një shpjegim për këtë, ne bazohemi nga të dhënat që marrim nga agjenti tatimor që kemi ujësjellës kanalizime Korçë që ka të gjitha familjet që ka abonetë, të dhënat që mbledhim nga kryepleqtë e njësive administrative dhe nga administratorët e rajoneve të gjitha këto familje që konsiderohen gjatë gjithë vitit si familje efektive të gjitha këto përlllogariten si familje për vitin në vazhdim.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Përgjigjia është të ardhurat llogariten mbi bazën e familjeve efektive, përsëri pyetje për drejtorinë e të ardhurave mbledhja e taksës për tokën buqësore pse është debia kaq e madhe dhe çfarë masa shtrënguese kemi aplikuar ne për ta mbledhur këtë detyrim.

Drejtori i të ardhurave dhe taksave vendore S.Prifti: Kapacitetet për tokën buqësore ne i kemi pasqyruar në material dhe janë të dhëna faktike sipas zërit kadastral që ne jemi të detyruar ti planifikojmë ndërkohë që realizimi për këtë calon por duhet të theksojmë që në vitin 2015 ku ne administruam komplet njësitë administrative taksa mbi tokën buqësore mbledheshe 4 milion e gjysëm të reja ndërkohë që nga 2015 dhe në vazhdim ky arkëtim ka qënë pesëfish më i madh 20 milion që mbledhim çdo vit nuk mbledhim vetëm nga të rregulltit por edhe nga debitorët por parimi është nëqoftëse kapet një debitor ne i mbledhim detyrimet e prapambetura dhe me pas kapim vitin korrekt. Edhe me familjarët edhe me debitorët e tokave buqësore ne i ndjekim masat shtrënguese dhe janë që nga bllokimi i llogarive bankare në rastet kur ju gjenden vënien bazë hipotekore për pasuritë e palujtshme.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Pyetja tjetër lidhet me taksën e ndikimit mbi infrastrukturë, parashikimin e saj. Tani taksa e ndikimit në infrastrukturë si çdo lloj takse nuk është se bazohet mbi një gjë të sigurt por bazohet mbi pritshmëritë tona mbi kërkesën që do të ketë mbi ndërtimet e reja në Korçë dhe ka sinjale për projekte qoftë rezidenciale qoftë turistike të përmasave të mëdha që ne besojmë se do të çojë në këtë nivel të taksës të mbledhjes për infrastrukturë. Ajo që

ne kujdesemi vazhdimisht është të kemi një balancim midis mbledhjes të të ardhurave dhe realizimeve. Bëjmë parashikim me informacionin që ne kemi dhe më pas e ndjekim ekzekutimin e buxhetit gjatë vitit duke e mbajtur në mënyrë të balancuar. Për sa i takon këndeve të lojrave mirëmbajtjen e atyre ekzistuese apo shtimin në ndërrmarjen e shërbimeve publike kemi parashikuar buxhet për mirëmbajtjen e këndeve ekzistuese të lojrave dhe ne ndërhyjmë në ato elementë që dëmtohen më shpesh por ne duhet të përqipemi të gjithë së bashku të ndërgjegjësojmë banorët e atyre lagjeve që të kujdesen për fëmijët e tyre që mos i keqpërdorin këto kënde lojrash. Incentivim për të përfshirë të rinjtë e të rejat nga familjet në nevojë në projektet e bashkisë që lidhen me teknologjinë. Në incetivim janë përfshirë këto kategori nga informacionet që kam nga donatorë të ndryshëm sepcifikisht për këta të rinj. Ndërkohë që në pjesën e mbështetjes që qeveria shqiptare ka dhënë për kurset e kodimit punëkërkuesit e papunë e kishin 100% të mbuluar pagesën e kursit. Për pjesën e strehimit social të japë një shpjegim Mirela. Ligji për strehimin social parashikon disa kritere duke filluar nga banesa me kosto të ulët që ai që është aplikant përfitues e mer dhe paguan në vite këstin e banesës dhe për këtë ne jemi në bashkëpunim me entin kombëtar të banesave ju kemi dhënë një turall në dispozicion sepse ata i ndërtojnë bashkëpunimi ka qënë ne vemë në dispozicion truallin dhe ata bëjnë ndërtimin. Për familjet me të ardhura shumë të ulta duam të bëjmë një projekt me një numër të caktuar banesash për ti akomoduar këta, ndërkohë janë dhe skema të tjera ku janë kredia me interes të subvencionuar ku krahas skemës të qeverisë kemi dhe skemën tonë si bashki, është bonusi i strehimit që aplikanti e gjen vetë shtëpinë dhe bashkia në varësi të të ardhurave të tij paguan një pjesë ose tërësisht koston e qerasë kemi dhe përmirësimin e kushteve të strehimit. Një pyetje ishte për qëndrën e eventeve sa është vlera e investimit, nuk kemi aktualisht vlerën e investimit projekti do të zbatohet në shkallë, gjatë këtij viti kemi diskutuar me Fondin Shqiptar të Zhvillimit të bëjmë një prevetim për infrastrukturën bazë që ne na duhet për të zhvilluar atje festën e birrës. Mbështetja për turizmin natyror, patjetër që turizmi është shumë i rëndësishëm produktet që lidhen me turizmin e natyrës janë të rëndësishme, për shembull infrastruktura rrugore që do të lidhë Dardhën me Sinicën është një projekt në funksion të zhvillimit të turizmit natyror. Projekti i aeroportit nuk është turizëm natyror por turizëm i aventurës edhe pista e Dardhës është një turizëm i natyrës. Transporti urban turistik është një nga shqetësimet që na ka dalë turistët për të dalë jashtë qytetit të Korçës një nga vështirësitë që ata hasin është pjesa e transportit me rritjen e turistëve të huaj kjo do dalë si kërkesa dhe kur të dalë si kërkesë dhe ekonomia e tregut me levat e saj veprojë do rritet interesi i operatorëve për të mbuluar këtë shërbim. Për sa i takon ndërtimeve në sajte historike konkretisht në fshatin e Voskopojës në kishën e "Shën Ilias" tani gjithsecili këtu është i lirë të ketë opinionin e tij për zhvillimit dhe kjo është e keqja arkitekturës dhe urbanistikës që nuk është së është shkencë ekzakte, projekti në fjalë ka marë miratimin nga linja e mbrojtjeve të qëndrave historike dhe zonave të mbrojtura që është Instituti i Monumenteve të Kulturës dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimit dhe pastaj bashkia e Korçës ka bërë pajisjen me leje ndërtimi por është një projekt që është miratuar në instancat përkatëse. Pavarsisht se e thonë të gjithë Korça është qyteti më i mbrojtur në Shqipëri e pranuar botërisht edhe nga vëndasit edhe nga të huajt. Zhvillimi urban duhet të jetë i balancuar që dhe të ruajë atë gjë që është historike dhe ka vlerë që duhet rruajtur por edhe të lejojë të zhvillohet. Fondi Shqiptar i Zhvillimit është një nga agjensitë më të rëndësishme qëndrore në Shqipëri i cili mbulon projekte zhvillimore dhe fatmirësisht ne kemi një bashkëpunim shumë të mirë me Fondin Shqiptar dhe një numër i madh i projekteve që unë përmenda që ju pyetet që do i prekim edhe më vonë mbështet pjesësisht ose totalisht ngab Fondi Shqiptar i Zhvillimi të cilin dua ta falenderoj, dhe ajo qëndër do shërbejë si një njësi ku praktikisht ata që duan të punojnë në

industrinë e turizmit do kenë mundësi të aftësohen nëpërmjet të punuarës. Si sistem i përgjithshëm aq më keq edhe profesional kemi mangësi që bëjmë shumë teori dhe pak praktikë. Tani çfarë do bëhet me fshatrat me potencial turistik sic është Vithkuqi që ne duam ta mbështetim dhe e kemi mbështetur me infrastrukturë kryesore me rrugën, meqënëse më përmende ujin e pijshëm specifikisht më vjen keq ta them që kam angazhuar 20 milion lekë të reja për projektin e rikonstruksionit të plotë të ujësjellësit të fshatit Vithkuq dhe është një projekt i cili nuk ndodhi për shkak se shumica e banorëve atje donin një ujësjellës pa matësa dhe ujësjellës pa matësa ne vitin 2020 sa ishte atëherë dhe shumë me përpara dhe në vazhdim nuk mund të ketë. Unë do kem një vëmendje të shtuar ndaj Vithkuqit sepse realisht e konsideroj një prej zonave që ka të njëjtin potencial si Voskopoja. Projekti i gazit është projekti më i rëndësishëm i infrastrukturës që ne kemi në vazhdim, do i japë zgjidhje problematikës të ngrohjes patjetër që të jetë i suksesshëm duhet të ketë dhe zgjidhjen teknike dhe të jetë i përballeshëm ekonomiksht nga banorët. Kjo është parim sepse ti mund ta bësh si zgjedhje teknike po të thuash se çmimi do jetë shumë herë më i shtrenjtë se alternativat e tjera nuk do ta përdorë njeri, kompania Socar është angazhuar nga qeveria Shqiptare për të parë mundësinë e realizimit të një projekti pilot të gazifikimit në Shqipëri në qytetin e Korçës, shumë e mirë për familjet, për mjedisin dhe për bizneset. Unë do të jem shumë i lumtur nëqoftëse do realizohet dhe do realizohet se sa do jetë e përballeshme ta dhashë shpjegimin Socar nuk do hyjë një projekti ku të bëjë investimin dhe mos ketë mundësi të shesë gaz. Tani për Asdrenin, Asdreni është një prej figurave me të ndritura historike të Shqipërisë të Rilindjes Shqiptare, të periudhës të pavarësisë, autori i himnit specifikisht meqënëse më përmedënde Asdrenin unë përmenda projektin e qendrës të Drenovës dhe projekti i qendrës të Drenovës nuk ka vetëm sheshin por ka edhe godinën dhe një pjesë ka qënë muzeu i Asdrenit e cila do rikonstruktohet dhe në fasadë do vihen vargjet e himnit kombëtar, ka pasur dhe propozime ku njëri prej tyre ishte dhe Pandi që të shihet mundësia e bërjes të një busti apo një monument. Kemi bërë dhe një aktivitet vitin e kaluar ku përqipemi ti kujtojmë këto figura. Për sa i takon infrastrukturës artistike është e vërtet që arti nuk është llac dhe tulla por është po aq e vërtetë që kërkon disa standarte, nuk mund të them që infrastruktura është kryesorja por kërkon disa standarte. Ke një listë atje me aktivitete të ndara që nga arti i kulturës, teatri dhe biblioteka një listë shumë të gjatë me aktivitete bëjmë. Tani artin e bëjmë. Një kriter që ne kemi është të kemi një kalendar aktiviteteve gjithëpërfshirëse që ti prekim të gjitha shijet. Ndërsa për sa i takon mbështetjes të formacioneve të ndryshme të qytetit ne kemi mbështetur si bashki të gjitha formaionet që ekzistojnë në qytet. Në raport specifik me orkestrën e harqeve i cili është një formacion i krijuar në 6 vitet e fundit dhe është mbështetur nga bashkia dhe nga ana ime, më kanë kontaktuar para pak kohësh, para miratimit të buxhetit me një kërkesë për të parë mundësinë e rritjes të pagesës që bashkia jep për këtë formacion, Kostika si drejtues i këtij formacioni me një grup pjesëtarësh të këtij formacion dhe i kam thënë në parim duke mirëkuptuar kërkesën që çdo profesionist mund të ketë për tu paguar më tepër ky nuk bëhet në formën e diskutimit siç e bëni ju por në trajtën e një analize. Kam marrë informacion nga Kostika se kur është krijuar, cilat janë aktivitetet dhe se çfarë kanë marrë përsipër që të kryejnë dhe cilat janë planet për të ardhmen. Kur them diçka këtu në mbledhjen e këshillit i pranishëm edhe drejtuesi i formacionit unë nuk mund të them gjëra kot që ai mund të mi kundërshtojë. Ata kanë thënë ne jemi me të mirë se të tjerët dhe mos na krahasoni me të tjerë dhe ata që e kanë thënë një pjesë jo të gjithë e kanë pasur qëndrim këtë gjë. Vizioni im është të mbajmë formacionet ekzistuese të mundësisht të shtojmë të reja dhe ti mbështesim me aq sa kemi mundësi. Kërkesa nuk mund të jetë jo vetëm për orkestrën e harqeve por për asnjë formacion tjetër na rrit ne tani pagën sepse nuk bëjmë asnjë lloj analize kanë qënë të paguar më shumë se

gjithë formacionet e tjera më shumë se Kori, se Banda, Se Ansambli i Skënderbeut dhe në buxhetin e ri kemi parashikuar një rritje për të gjitha këto formacione duke pasur parasysh edhe pjesën e barazimit sipas kontributeve që japin, ja kemi rritur dhe orekstrës të harqeve siç e kam gjykuar unë në baze dhe të informacionit që kam marrë nga Qendra e Artit dhe Kulturës. Për sa i përket moshës të tretë është e vërtetë që demografia në qytet po ndryshon për shkak fenomeneve demografike po rritet numri i pjestarëve që i takojnë moshës të tretë dhe kjo duhet të sjellë një vëmendje të shtuar nga bashkia kundrejt tyre, disa inicitaiva që ne kemi mbështetur në vite janë transporti urban, qendrat e moshës të tretë. Për sa i takon kapaciteteve shtesë rezidenciale nuk është se kemi parashikuar diçka këtë buxhet sepse është diçka që kërkon buxhete të mëdha dhe unë mendoj që ajo që ne mund të bëjmë është të forcojmë kapacitetet ekzistuese të ofrimit të shërbimeve në shtëpitë e tyre për shembull bërjen e pazarit dhe aktivitete të tjera që ata nuk i bëjnë dot vetë. Kriteret e përzgjedhjes të pallateve që do të termoizolohen tani, ky është një projekt që do të financohet 12 godina mos gaboj do të mbështeten nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe ata kishin kriteret e tyre që godinat duhet të jenë në bllok ose të jenë në grup objektesh pra jo objekte individuale, kanë kriter ngritjen e asamblesë të bashkëpunarëve dhe caktimin e administratorëve që është një gjë që duhet të ishte bërë pavarësisht këtij projekti. Fondi 10 milion lekë që nuk është përdorur ka dy vjet është sepse nuk ka pasur interes nga ana e banorëve që të organizohen të krijojnë asamblenë, të venë administratorin dhe të vijnë në bashkinë tonë të thonë ne duam të bëjmë izolimin e pallatit ti ke lënë këtë buxhet vër ti 50 % vë dhe unë 50 % e hajde ta bëjmë. E parë kshu në parim këto janë të gjitha godina private dhe unë nuk e kam detyrim ti termoizoloj 100% me lekët e bashkisë unë po përpiqem duke trokitur në donatorë duke krijuar ato modelet e para dhe të rrit ndërgjegjësimin, por ndërgjegjësimi nuk mund të jetë nga ana e banorëve hajde tani na bëj termoizolimin e pallatit ti dhe mos ve unë asnjë lekë. Fondi 10 milion lekë të reja është atje në dispozicion është publik dhe ju ftoj ta përcillni si informacion tek komunitetet dhe do përdoret sipas aplikimeve. Disa shëmbuj bashkëpunimesh i kemi patur thotë Kletjoni jo për termoizolimin por i kemi patur për ndërhyrje të tjera private.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Po i jap fjalën Zv.Kryetarit për të diskutuar për pjesën e qenve të rrugës.

Nënkryetari K.Kita: Ne vazhdojmë të miratojmë një fond për kujdesin e qenve, për sterilizimin e kapjen e qenve nëqoftëse jeni në dijeni ne kemi një godinë ku i mbajmë qentë endacake me një kapacitet prej 24 qensh dhe tani kemi bërë një procedurë që ishte në fund dhe besoj do jetë prokuruar për rritjen e kapacitetit të qenve dhe për sjelljen në një standart tjetër me standartet europiane për mbajtjen dhe ushqerjen e qenve endacake. Jo më vonë se dje ne mbyllëm dhe procedurën për sterilizimin ku dijenin time janë sterilizuar, matrikulluar dhe janë lëshuar përsëri në habitatet e tyre rreth 104 qen, këtë fondin e kemi bërë disa herë dhe është viti i tretë ky që e miratojmë. Sipas ligjit për ata qen që shfaqin rrezikshmëri për njerëzit dhe janë të egërsuar apo janë me sëmundje të transmetueshme ligji e përcakton dhe e ka të qartë se çfarë procedure duhet të ndjekim. Janë shumë pak kompani të interesuara dy kompani në dijenin tonë një nga Fieri dhe një nga Beratit për të bërë këtë punën e kapjes, sterilizimit dhe matrikullimit është një kosto shumë e lartë në fakt shkon diku në 50 deri 60 mijë lekë të vjetra gjithë ky procesi për kapjen e qenve. Kemi kërkuar edhe bashkëpunim nga Shoqatat për të na ndihmuar pasi procesi i kapjes është një proces i vështirë. Me shtimin e kapaciteteve të vendbanimit të qenve ku po e bëjmë tek zona rruga e Voskopojës do kemi mundësi që të mbajmë më shumë qen dhe ti trajtojmë ata por duke shmangur gjithë këta qen që janë me sëmundje dhe janë agresivë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Pyetja e rradhës ishte për fermerët se çfarë mund të bëjë bashkia për ti ndihmuar në drejtim të shitjes të tyre dhe në drejtim të mbrojtjes nga dëmet që shkaktohen nga faktorët atmosferikë. Tani për mbrojtjen ndaj dëmeve që shkaktohen nga faktorët atmosferikë besoj që ndihma më e mirë që mund tju bëjmë është ti informojmë dhe ti nxitim që të aplikojnë tek skemat e mbështetjes qoftë skema e qeverisë qoftë skema e mbështetjes me fondet e BE dhe brenda tyre ka komponentë për bërjen e rjetave anti breshër, e dyta është duke gjetur mënyrat sesi produktet e tyre të sigurohen që dhe kjo është mardhënia ndërmjet fermerëve edhe sektorit privat të sigurimit ajo që mund të bëhet por jo në nivel lokal në nivel qendror deri para disa vitesh nuk ka funksionuar mbase funksionon tani është që shteti mund të marrë përsipër mbulimin e një pjesë të primit të sigurimit por pjesën tjetër duhet ta mbulojë patjetër si në çdolloj biznesi ai që bën biznesin pra fermeri në këtë rast. Për sa i takon shitjesh ne kemi investuar vitet e fundit në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës të tregjeve të shitjesh në bashkinë e Korçës i fundit ka qënë tregu i gjësë të gjallë ndërkohë projekti më interesant që kemi tani lidhet me këtë qëndrën e ekselencës të buqësisë dhe blegtorisë ku brenda saj duam të kemi edhe një linjë për seleksionimin, larjen dhe paketimin e mollës që është një gjë që besoj do i rritë vlerën këtij produkti që është një produkt kryesor për buqësinë e bashkisë të Korçës dhe do i krijojë duke qënë me një paketim standart siç kërkon tregu mund të krijojë mundësinë edhe për gjetjen e tregjeve të reja dhe kjo qëndër jo vetëm do e paketojë sipas standartit por do jetë edhe në funksion të gjithë fermerëve që meren me këto lloj kulture, atje mund të krijohet mundësia që fermerët ta prodhojnë individualisht produktin ta çojnë tek qëndra dhe atje të lahet dhe të paktohet me standarte dhe më pas dhe mund ta shesin së bashku. Tani për pjesën e sportit ishte si shpërndahet mbështetja e bashkisë për sporte të ndryshme. Ne përqipemi të mbështesim të gjitha sportet që janë aktive në qytetin e Korçës apo dhe ato që mund të dalin të reja, masa e mbështetjes varet pak edhe nga performanca sportive por edhe ngaimpakti që ky sport ka në komunitet siç është volejboli ku ne për herë të parë kemi arritur të mbushim pallatin e sportit është sport që ka impakt edhe në komunitet por kjo nuk do të thotë që ne nuk do të mbështesim dhe sportet e tjera. Pjesa e sinjalistikës është shumë e rëndësishme për një qytet, mendimi im është që ne duhet të ecim në drejtim të punës të sinjalistikës edhe nëpërmjet përzgjedhjes të kompanive të caktuara që meren me këtë punë por edhe nëpërmjet ngritjes të kapaciteteve tona. Në lidhje me fondin pyjor ne çdo vit investojmë në pyllëzime, aktualisht projektin e pyllëzimit e kemi tek zona e Voskopojës ku patëm një zjarr para disa vitesh dhe u dogj një sipërfaqe që ne po e pyllëzojmë dhe është 21 hektarë për vitin tjetër kemi lënë 12 milion lekë të reja, ideja është edhe se duam edhe se e kemi detyrim ligjor të gjitha të ardhurat që ne krijojmë nga shfrytëzimi i pyjeve i rikthejmë në pyje por jo thjesht pyllëzim mund të jenë rrugë autopajore. Në lidhje me bursat e nxënësve ekselente projekti ka filluar dhe në muajin dhjetor e kanë marrë përfituesit. Për sa i takon ngrohjes në shkolla është shumë e rëndësishme është pjesë e infrastrukturës shkollore dhe ne kujdesemi që në të gjitha objektet që rikonstruojmë pjesë e rikonstruksionit të jetë dhe ngrohja qëndrore e këtyre shkollave. Kemi zgjatur që para dy vitesh periudhën e ngrohjes e kemi zgjatur me një muaj e kemi bërë 1 nëntor- 31 mars, por kur janë ditë më të ftohta stafi i shkollës mund ta mbajë atë ngrohjen edhe jashtë orarit dhe kur janë ditë më të ngrohta ta mbajë më shkurt. Këto ishin pyetjet që unë kisha mbajtur.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit Zoti Kryetar dhe unë i ndoqa me vëmendje të gjitha pyetjet që u adresuan i kisha mbajtur shënim dhe ju ju përgjigjët të gjitha atyre. Tani është e hapur fjala për diskutime nga këshilltarët reth projektbuxhetit 2024. Fjala është për ju.

Këshilltar A.Habip: E nderuar zonja Kryetare, të nderuar këshilltarë së pari unë mendoj që ky buxhet është i formuluar mirë i detajuar në të gjitha fushta dhe aktivitetet për bashkinë e Korçës, se dyti ka një harmonizim të nevojave që komuniteti ka në bashkinë tonë bashkë me njësinë administrative dhe mundësitë financiare të cilat ajo ka në dispozicion, së treti ky buxhet është i fokusuar sipas mendimit tim në mbështetjen për disa kategori shoqërore siç janë të rinjtë, të moshuarit dhe shtresat në nevojë. Unë po marr disa aspekte të planit të buxhetit të cilin ekzekutivi na e ka paraqitur, për sa i përket turizmit ekzekutivi ka paraqitur një sërë evente për vitin 2024 të cilat do të sjellin një impakt në ekonomi dhe biznese nërmjet turistëve vendas dhe të huaj. Të gjitha eventet që i citoi dhe kryetari së bashku me eventin më të madh që është festa e birrës na japin një të dhënë të rëndësishme që Korça do vazhdojë të jetë një që është tërheqës për turizmin. Një e dhënë që është shumë sinjifikative është totali i shpenzimeve të planifikuara për turizmin që është 37.4 milion lekë që përfshin 67 % të buxhetit të planifikuar për zhvillimin ekonomik vendor që do të thotë që fokusi i bashkisë është rejt turizmi, për sa i përket mbrojtjes ndaj mjedisit është parashikuar një shifër prej 153 milion lekë i cili përfshin pastrimin e rrugëve, parqeve mbledhjen dhe depozitimin e mbetjeve, për përkujdesjen sociale janë parashikuar 56.6 milion lekë kjo tregon që dhe për këtë kategori ka një kujdes të veçantë, për sportin dhe argëtimin janë planifikuar 153 milion nga të cilat 46 milion janë vetëm për kulturë e cila këtë vit do të ketë 46 aktivitete dhe me një rritje 23 % me vitin aktual gjithashtu është menduar një buxhet prej 42 milion lekësh për disiplinat sportive, arisimi bazë dhe parashkollor unë do të përmënd vetëm një shifër që është shuma prej 24 milion lekë që është shuma për projektet inovative.

Këshilltar L.Petri: Kam përshtypje që nuk është në nivel diskutimi përsëritja e shifrave që i kemi dhe në materiale.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Të lutem mos ndërprit fjalën, nuk mund ti ndërpres fjalën këshilltarit për materialin që ka përgatitur për të folur.

Këshilltar A.Habip: Kam marrë vetëm disa shifra nga buxheti, për arsimin e mesëm janë parashikuar 72 milion lekë nga të cilat për risi është fondi 4 milion lekë që është parashikuar për bursat e ekselencës, si përfundim të nderuar këshilltarë unë mendoj që ky buxhet do ta bëjë Korçën edhe më të pastër sec është edhe më të ndriçuar edhe më të gjelbësuar edhe më atraktive për turistët. Faleminderit.

Sekretare e Këshillit E.Naçi: Është shkelje kjo duartrokitje në sallë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Kjo mënyrë e duartrokistjes nëse i hapim precedencë do të bëhet edhe për çdo fjalë që ju do thoni, ju lutem të respektojme vendimin e gjithësecili.

Këshilltare S.Dinellari: Edhe njëherë ju përshëndes të nderuar kolegë dukë qënë se shkoi vonë dhe të gjithë jemi të lodhur dhe përsëritja e gjërave që i thamë është bërë e lodhshme, shifra pafund ndoshta ka nevojë më tepër për interpretimin të atyre shifrave dhe kur unë bëra pyetjen për numrin e popullsisë, mbledhjen e taksave të cilat detyrimisht janë dy polet të ardhurat dhe shpenzimet të këtij projektbuxheti që do të votojmë sot nuk e bëra kot duket që po shkojmë në një filozofi parimore kontradiktore, nga njëra anë thuhet që do ndihmojmë me strehime ato



familje që kanë nevojë për ndihmë ekonomike dhe nga ana tjetër nuk u japim bursa këtyre fëmijëve me ndihmë ekonomike, gjë e cila në vazhdimësi edhe për shpenzimet të adresuara në ato prioritetet që u përmëndën nga kryetari janë të dukshme kontradiktore. Zotëria që paraqiti mbledhjen e taksave dhe të ardhurave tha se ne e evidentojmë numrin e popullsisë nga të dhënat e ujësjellësit në mos gabohem nga kryepjeqtë dhe nga administratorët e njëjstëve. Tani unë po e bëj këtë pyetje por është pyetje retorike, e dimë ne numrin e popullsisë të qytetit të Korçës vërtet apo bëjmë naivet?

Kujt i adresohet ky projektbuxhet i adresohet asaj grupmoshe që u përmend shumë herë dhe është shumë herë më e lartë apo apo të rinjve që është shumë herë më i ulët, sa i adresohet këtyre të rinjve dhe në bashkë punim me cilat institucione bëhet sepse të rinjtë siç thatë ju evidentohen nga drejtoritë e arsimit të mesëm të përgjithshëm profesional apo edhe nga universiteti?

Pjesa e grupmoshës të punës kërkohet një balancim me ata që kërkojnë punë, kush i punëson sa punësojmë ne sepse po bëjmë një projekt që do marrim të ardhura nga kush, nga pensionistët që u përjashtuan tek ato taksat dhe tarifatat e bashkisë sepse do mbledhim të ardhura apo jo që do i adresojmë kujt të atyre që vijnë turistëve të huaj apo qytetarëve të qytetit të Korçës?

Është bukur që ta themi po kshu duhet të jetë por nëse marim disa statistika të tjera në lidhje me lindshmërinë në qytetin e Korçës dhe vdekshmërinë në qytetin e Korçës duhet të jemi më korekte dhe më të matur. Ajo që unë dua të lexoj ashtu siç duhet dhe me indikatorë tregues të kërkimi të vërtetë mbi hartimin e një projektbuxheti është që ne këtë projektbuxhet ur ta miratojmë ta ndjekim hap pas hapi për ta parë sesa i vërtetë është ai sepse qytetarët nuk arrijnë dot ta ndiqnin se çfarë ne kishim parashikuar për taksimin e tyre apo tarifimin e tyre, e pamë dhe në takimet të cilat cuditërisht nuk u ndoqën ashtu siç duhet apo të parashikuara nga ligji për konsultimin publik që mos vihem në përsëritje të atyre që kemi thënë disa seanca të mëparshme ky projektbuxhet ka shumë problematike që ne paraprakisht duhet ti kishim diskutuar dhe jo në një seancë ku janë 15 pika diskutimi dhe pikat e tjera që duhet ti diskutonim për projektbuxhetin ashtu siç e thatë edhe ju me shifra se qytetarët nuk besoj se do i dinë dhe do i mbajnë mend do të kishin nevojë për më tepër kohë, faleminderit.

Këshilltari A.Taho: Unë na fakt do të flas si kryetare e Komisionit të Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut e kam lexuar të gjithë projektbuxhetin por jam përqënduar tek çështjet që lidhen me komisionin të cilin unë bëj pjesë, kam patur mundësi në ditë të caktuara të takoj edhe drejtuesit e institucioneve që merem me shërbimet sociale dhe kam parë që në këtë projekt buxhet projekti për kujdesin social prekte të gjitha kategoritë duke i ndihmuar ato me vlera monetare duke i orientuar drejt tregut të punës duhet të theksoj këtu që drejtoria kishte një bashkëpunim të vazhdueshëm me institucionet e tjera me orgonazitat jofitimprurëse. Të gjitha projektet ishin të detajuara me buxhet të përcaktuar. Unë mendoj që ky buxhet është buxheti i të rinjve, kjo është arsyeja e vetme pse ftoj të gjithë këshilltarët pa dallime politike ta votojnë, ne flasim sot me këtë buxhet për modele inspiruese dhe duke pasur në fokus të rinjtë unë mendoj që ky qytet, kjo bashki është në rrugën e duhur prandaj ju ftoj të gjithëve duke menduar për të rinjtë pa dallime politik, faleminderit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Fjala për Zotin Osmani.

Këshilltar D.Osmani: Faleminderit Zonja Kryetare megjithëse duhet ta merja fjalën i pari, në lidhje me diskutimet ju kërkoj pak ndjesë këshilltarëve sespe dhe unë do merem pak me shifra duke qënë dhe profesioni im por do mundohem ti bie shkurt që mos i vonoj sepse dhe koha ishte

e gjatë i vetmi merak që kam ishte pyetja që ja u bë ju zonja kryetare dhe sekretares arsyeja pse duhet të ishte kaq e gjatë dhe materialet plot sot ndërkohë që kishim një nga pikat më të rëndësishme për të diskutuar nuk e mora këtë përgjigje faleminderit, në lidhje me buxhetin mesa konstatoj është një buxhet i cili këtu do të jemi përsëri në fund të vitit 2024 të jemi të gjithë shëndoshë e mirë uroj i cili nuk do të realizohet ose do realizohet pjesërisht, i sigurt jam që do të realizohet që pagat punojësit do i marrin por investimet dhe planifikimet e tjera më vjen keq por me këto shifra dhe me këto rezultate të pritshme për vitin 2023 nuk ka si të realizohet ndoshta i prisni që të bihen nga qielli këto lekë e them këtë sepse ne kemi një pasqyrë të ardhura dhe shpenzime ku nga ky buxhet është parashikuar që vetëm për shpenzime personeli dhe shpenzime koherente operative transferta e të tjera të përdoren 85% të këtij buxheti dhe nga të ardhurat që krijon bashkia nga mbledhja e taksave dhe tarifave 77% e tyre shkojnë për pagat e administratës të bashkisë dhe kjo arsye mbështetet në disa fakte po të shohësh të ardhurat e parashikuara dhe ato të pritshme që do të realizonit në vitin 2023 ju keni një plan për 2024 në rritje 100% nëqoftëse prisni që të arkëtoni 295 milion për vitin 2023, për vitin 2024 prisni të realizoni 626 milion gjë e cila është e pamundur sepse të presësh që do të realizosh 100 % sepse me këto do i mbulonit dhe këto shpenzimet që keni planifikuar. Ashtu dhe për të ardhurat jotatimore prisni që këto të rriten 30 % në krahasim me pritshmëritë dhe në totalin e tyre këto të ardhura ju e prisni që të rriten me 60% në vitin 2024 se si do të rriten vetëm ju e dini. Unë mendoj që është një planifikim i gabuar sepse në të kundërt nuk e di por nuk e besoj se ka personel të pakualifikuar në bashki. Dua të shpreh dhe diçka në lidhje me buqësinë dëgjova një shifër nga kryetari që është planifikuar 150 milion një vlerë për buqësinë, nuk mendoj që çdo gjë është zi edhe për pjesën e infrastrukturës edhe të buqësisë por unë mendoj që do të duhen më shumë fonde për të mirëmbajtur atë tokë buqësore që punohet pa cka se dhe nga bashkia dhe nga ndërrmarja e shërbimeve publike e vlerësoj faktin që ka vite që mirëmbahen edhe kanalet kullues edhe pjesa e infrastrukturës të parcelave por mendoj që fondet duhet të jenë më të mëdha dhe të vlerësohet sepse po ta shohësh ne kemi një buqësi cili ka një kosto të lartë dhe duke pasur një kosto të lartë në prodhim ne jemi jo konkures në treg, sado të investoni ju si bashki problemi më i madh që ka buqësia sot është rritja e kostove kosto të larta kjo është shkak dhe arsye dhe parcilizimit të ngastrave e mungesës të shumë gjërave që kanë lidhje me të por është një pikë e cila ne po shkojmë nga viti në vit dhe të gjithë ne e ndjejmë që fshatrat po braktisen dhe braktisja e tyre është shumë herë më e madhe sesa qyteti, unë mendoj që duhet ta rishikoni, faleminderit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, kush e do fjalën përsëri?

Këshilltar E.Nexhipi: Ky buxhet që do të miratojmë sot vjen si rezultat i një pune të gjatë që është bërë për ta përgatitur por duke u mbështetur dhe në një eksperiencë shumë vjecare patjetër që gjithmonë ka vend për përmirësim por si buxhet ka dy drejtime kryesore shërbimin dhe investimin, kur flasim për shërbimin pa diskutim që shërbimi ofrohet nga njerëzit dhe unë me arsyetimin tim e justifikoj dhe faktin e shifrave që lidhen me strukturën mbështetëse nuk është struktura vetëm administratë e bashkisë, ajo shifra 1090 punojës janë stafi i bashkisë, struktura e bashkisë, ndërrmarja e shërbimeve publike, ndërrmarja mbështetëse e çerdhës dhe arsimit, qendra e artit dhe kulturës, gjithçka që ka varësi direkte nga bashkia por dhe funksionet e deleguara që janë edukatoret, kuzhinieret pra shifra 1090 është një shifër që i referohet të gjitha shërbimeve që ofrohen nga autoriteti vendor, nuk mund të them që investimet e vitit 2024 i zgjidhin të gjitha nevojat por duke qënë dhe një buxhet i hapur sapo u informuam nga kryetari që me aktin e fundit normativ të qeverisë buxhetit të bashkisë Korçë i shtohen rreth 60 milion lekë

të reja që nuk janë të përfshira këtu. Ky buxhet do pasqyrohet në janar me tepricat që ka vitin 2023 qoftë edhe shtesën në buxhet që po vjen nga ky akt normativ. Besoj që në këto ndryshime do gjejnë vend dhe disa projekte që kemi diskutuar në këshillin e qarkut siç mund të jetë muzeu i "Etnografisë" muze i munguar në rajonin tonë dhe mbështetja për sektorin e turizmit për mua është shumë e rëndësishme, por do sygjeroja për matjen e performancës të përgatiten indikatorë që të jenë në funksion të punës të administratës, është një sektor që Korça ka shumë vite që e mbështet. Mbledhja e tarifave duhet të jetë e matshme për mua që mos gjendemi para situatës që njerëzit të thonë jo ishte puna në këtë nivel po ishte në atë nivel. Për sa i takon termoizolimit unë jam plotësisht dakort me parimin që këto janë objekte private dhe kërkojnë dhe angazhimin e banorëve dhe pronarëve por nuk jam dakort që të qëndrojmë indiferentë, ligji na detyron që dhe kur nuk organizohen vetë banorët duhet të ndërhyjme ne që të përfshihen, ligji i ka të parashikuara bashkia mund të krijojë një ndërmarrje dhe ti detyrojë banorët sipas mënyrave që janë të parashikuara të paguajnë atë detyrim për ata që e kanë të mundur, ka dhe zona ku pallatet kanë mbushur vjetërsinë e tyre dhe ne nuk mund ti lemë të bëhet si të bëhet sepse do jenë pasojat në vijim duhet të gjejmë mekanizma sepse nuk është normale që dikujt ti rikonstruktohet banesa dhe të ketë të njëjta tarifa vendore si pjesa tjetër. Për sa i takon transportit publik jemi qyteti i vetëm që e kemi dhe pak më të zgjeruar transportin publik me shërbim falas për pensionistët unë do ju sygjeroja që të mendoni për studentët ne si këshill qarku po mendojmë të mbështesim disa linja që lidhen me qytetet pranë nesh. Aksesit i zonave pranë Korçës siç mund të jenë fshatrat në një orar të mëvonshëm pas orës 4 ose 5 është thujse e pamundur transporti privat apo taksi. Unë ju ftoj ta votojmë duke e konsideruar një mbështetje jo për administratën por për zhvillimin, faleminderit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Fjala për Zotin Pllaha.

Këshilltar K.Pllaha: Kam dy komente e para për ju zoti Kryetar i Bashkisë ju jeni njeri i shifrave dhe unë jam njeri i shifrave dhe besoj që ne për të parashikuar shifrat e të ardhmes duhet të parashikojmë shifrat e të shkuarës dhe nëqoftëse shikojmë realizimin në vitetet e fundit në mbledhjen e të ardhurave nga taksat dhe tarifavat vendore ka qënë diku rreth 55 % jo më shumë se aq dhe si rrjedhojë pothuajse aq është dhe realizimi i shpenzimeve dhe investimeve pra duke parë këto shifra dhe buxhetin e vitit 2024 e pret i njëjti fat do mbledhim jo aq të ardhura që kemi parashikuar dhe si rrjedhojë i bie të realizojmë më pak investime nuk e di cilat investime do hiqen nga kjo listë që na propozohet shpresoj jo ato që janë me rëndësi të veçantë për publikun, unë do kisha një sygjerim për të plotësuar këtë mangësi para një muaji ka dalë plani i ri i rritjes i Komisionit European ku parashikohet një fond i vecantë për vendet e Evropës Juglindore që janë kandidatet dhe do ju sygjeroja të shtoni kapacitetet njerëzore të bashkisë të mund të përthithin sa më shumë nga këto fonde. Në përgjithësi ka qënë një groplënë që është për zgjerimin e BE përcakton grante dhe huamarrje të buta për gjithë vendet kandidatet dhe aplikohen, ky është një sygjerim për të plotësuar këto mungesa. Nga ana tjetër kam një koment për kolegët këshilltarë, për kryesinë e këshillit dhe për sekretariatit, unë jam një njeri që besoj në demokracia por sa më i madh është pushteti aq më e brishtë është demokracia, megjithatë ligjvënësi ka ndërrtur mekanizma për kontrollin e pushtetit dhe vetëekzistenca e këtij këshillit është një e tillë dhe unë ju ftoj që në të ardhemni ti japim këshillit atë rëndësi që ka për të kontrolluar punën e ekzekutivit, për të këshilluar, për të sygjeruar nëse ka zgjidhje të reja dhe e them këtë në vazhdimësi të një problematike që patëm me konsultimin publik që ishte detyrë e këshillit bashkiak ku ata pak që

ishin prezentë e panë që ishte një tallje me vetë ne si këshilltarë dhe me mos prezencën e administratës të bashkisë e cila duhet të ishte nuk po them për ekzekutivin sepse ai ka bërë konsultimet e veta po për konsultimet e këshillit dhe nuk po ju them që mos e votoni këtë buxhet sepse e di që nuk do ma dëgjoni fjalën por të paktën në të ardhmen të bëni ato detyrat tona si këshill me përgjegjshmëri duke ndjekur procedurat që kërkon ligji dhe duke i thënë këshillit rolit që i takon, faleminderit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit Zoti Pllaha, këto çështje i kemi diskutuar në mbledhjet e kaluara dhe unë nuk dua që ti rikthehem përsëri.

Këshilltar P.Tollkuci: Përshëndetje të nderuar kolegë, së pari meqënëse jemi në festat e fundvitit dua ta nis me një urim për këto festa. Gëzuar të gjithëve, sa më shumë shëndet në familjet tuaja dhe sigurisht sa më shumë produktivitet në vitin pasardhës në detyrën tonë si këshilltarë! Sigurisht që sot është një mbledhje shumë e rëndësishme sepse diskutohet mbi buxhetin e 2024 i cili është dokumenti më i rëndësishëm për ecurinë e bashkisë për vitin pasardhës dhe as kush nga ne nuk mundet kursesi të thotë mos e votojmë, ky është një dokument shumë i rëndësishëm për jetën ekonomik të këtij qytetit, çdo kryebashkiak që ka drejtuar qytetin e Korçës ka përgatitur një buxhetsipas kohës që ai e ka drejtuar bashkinë, nuk ka buxhet të keq sepse nu ka kryetar bashkie që i do të keqen qytetit dhe nuk ka këshilltarë që i do të keqen qytetit, as administrata përkundrazi buxheti reflekton dëshirën për të zhvilluar qytetin dhe për këtë arsye banorët na kanë besuar prej 16 vitesh sepse e kemi drejtuar mirë qytetin. Ajo që unë dua të them në lidhje me këtë qytet duke qënë se unë kam qënë pjesë e administratës dhe këtu një pjesë e administratës i kam gjetur kur kam erdhur në bashki në 2007 që do të thotë janë specialistë në hartimin e buxhetit dhe i cili ndërtohet mbi ato shtylla e parashikuara sipas ligjit, ky buxhet për mua ka tre shtylla të rëndësishme, zhvillimi ekonomik i qytetit me prioritet turizmin, teknologjia dhe buqësia por pa harruar sigurisht arsimin, sportin, kulturën dhe shtresat në nevojë. Të ecim para duke ruajtur më të mirën e arkitekturës tradicionale dhe duke sjellë vlera të reja në aspektin e zhvillimit urban. Nëpërmjet këtij buxheti shohim që Korça do të bëhet një kryeqendër e turizmit, Korç me buqësi të zhvilluar që mbështet fermerët, vëmendje e shtuar dhe mbështetje e shtuar e shtresave në nevojë, synohet rritja e të ardhurave dhe ulja e kostos të jetesës, krijimi i vendeve të punës, mbështetja e bizneseve të reja dhe mbështetja e fermerëve. Sigurisht që bashkia Korçë prej vitesh ka vëmendje drejt turizmit dhe teknologjisë të informacionit ne jemi bërë dhe shembull turizmi në rajon, po shohim qytetin tonë që është i tejnigopur me turizëm dhe vit pas viti shton kapacitetet e veta akomoduese dhe unë them që ky është rezultat i vendimeve të mira, vendimet e mira që ka marrë bashkia dhe ky është momenti i duhur që një dokument i mirë siç është buxheti i vitit 2024 të marrë miratimin e të gjithëve ne sepse gjëra të mira do vazhdojnë të bëhen për Korçën dhe qytetarët e saj.

Këshilltar L.Petri: Unë kam vetëm një sygjërim dhe më pas një propozim për procedurë, sygjërimi im është që në lidhje me turizmin të konsiderohet mbështetja për ato sipërrmarje siç mund të jetë përshebull furat e bukës dhe di të them që kontakti njerëzor dhe kur shikojnë një artizanat të gjallë turistët e vlerësojnë në mënyrë sipërore, propozimi për procedurë ZNJ.Kryetare që kam është që para miratimit ose mosmiratim të buxhetit ti jepet fjala qytetarëve në rastin në fjalë Maestro Tantos sepse ka që në orën 11 këtu dhe për më tepër u lakua edhe emri i tij dhe u

ngrit edhe çështja e dukurisë të formacionit të harqeve dhe mbështetjes për këtë formacion, faleminderit.

Këshilltar E.Bregu: Të nderuar kolegë, natyrisht që buxheti është pika më e rëndësishme e gjithë vitit për këtë arsye ne që në muajin tetor kemi kërkuar duke biseduar në këshill por edhe me shkresa që të gjithë këshilltarët të marin masat po ashtu dhe kryetari i bashkisë dhe administrata për të ndjekur procedurat e nevojshme të cilat do të na bënin ne të mundur që të krijojmë një buxhet me të mirë që do i shërbente qytetarëve, ne sot konstatojmë që ky buxhet nuk u shërben aspak qytetarëve për shkak se ky buxhet nesër në janar apo dhe pas një viti do të shikojmë që nuk do ketë sjellë asnjë përmirësim apo ndikim pozitiv në jetën e banorëve. Procedurat që ne kemi kërkuar të ndiqen kanë qënë të qëllimshme për tu ndjekur për shkak se ligjvënësi e ka përcaktuar procedurën me qëllim pjesëmarrjen e banorëve për të shprehur interesat e tyre dhe këto procedura nuk janë ndjekur asnjëherë, kryetari i bashkisë dhe administrata kanë bërë disa konsultime false dhe i kanë promovuar sikur kanë bërë diçka të madhe është fakt që një mbledhje u ndërpre dhe në çdo vend të botës mund të ndodhë të ndërpritet një aktivitet por në këto raste mbahen proceverbale dhe caktohet një ditë tjetër që mbledhja të vazhdojë, ka ndeshje të cilat ndërpritet për shkak të kushteve atmosferike ose ndodhi një incident por ajo nuk quhet e përfunduar por përsëritet ose vazhdon aty ku është lënë, kryetari i bashkisë me administratën nuk e bëri këtë, ne kërkuam që konsultimet të bëheshin në mënyrë të saktë dhe na është thënë që do caktohet një kalendar nga këshilli në bashkëpunim me kryetarin e bashkisë që për efekt shpenzimesh konsultimet të bëhen bashkë. Pse nuk është caktuar kalendar i thamë, sepse kryetari po udhëton shpesh këto kohët e fundit jashtë vendit dhe nuk e se kur do jetë këtu që të ketë mundësi të marrë pjesë dhe për këtë arsye nuk u caktua ai kalendar i përbashkët por u bënë më vete ashtu siç u tha që janë bërë këto konsultime nga ekzekutivi, më pas u caktuan që të bëheshin konsultimet nga këshilli dhe u caktuan dhe datat e sakta por para konsultimeve u aprovua paketa në kundërshtim me ligjin dhe në datat e caktuara për konsultim ne kemi marrë pjesë në orarin dhe vendin e caktuar një pjesë e këshilltarëve kemi qënë unë, Klajdi, Marsela e ndonjë tjetër që nuk e di sepse unë marr pjesë në disa rajone dhe zona ku jam caktuar të marr pjesë dhe aty nuk pashë asnjë nga administrata që është e detyrueshme as kryetari i bashkisë. Konsultimet që bëhen nga këshilli bëhen me pjesëmarrjen e administratës.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ne po diskutojmë për buxhetin ju lutem përmbahuni në pika e rendit të ditës sepse nëqoftëse do vazhdojmë të replikojmë për këto gjëra që i kemi diskutuar unë do citoja dhe përgjigjen që u është drejtuar Prefekti ju që e keni kërkuar para pak ditësh. Ju lutem për buxhetin nëqoftëse ka diçka.

Këshilltar E.Bregu: Nuk u bënë këto konsultime dhe konsultimet janë pikërisht për këtë qëllim që të marrim informacion nga taksa paguesi që buxheti të përgatitet në funksion të tyre , nëqoftëse do ishin bërë konsultimet sipas rregullit duhet mbajtur edhe procesverbale se çfarë u bë në këto konsultime. E kemi pyetur administratën në komisionin e financës ku unë kam marrë pjesë si i ftuar sepse nuk kam të drejtë vote dhe tha nuk kemi marrë asnjë procesverbal. Nxire procesverbalin me pyetjet dhe përgjigjet.

Sekretare e Këshillit E.Naçi: E ke dhe në faqen e këshillit të publikuar.

Këshilltar E.Bregu: Mua më duhen dokumentat në të cilat unë marr pjesë aktive dhe jam aty prezent.

Sekretare e Këshillit E.Naçi: Dy minuta e ke fjalën me rregullore.

Këshilltar E.Bregu: Tani duke ju referuar shkresave që ka sjellë Prefekti pas ankesave të një grupi këshilltarësh, është bërë fillimisht në nëntor nje ankesë dhe në datën 20 nëntor prefekti ka kthyer përgjigje duke vënë në dijeni bashkinë dhe këshillin por shkresa i është drejtuar këtij grupi këshilltarësh prej 11 këshilltarësh të cilëve nuk u është vënë në dispozicion asnjëhere nga kryetarja e këshillit dhe sekretaria që e kanë detyrim ligjor.

Më thuaj e ke vënë në dispozicion?

Sekretare e Këshillit E.Naçi: Nuk të kam kthyer unë përgjigje të ka kthyer prefekti, mua smë ka dërguar gjë prefekti.

Këshilltar E.Bregu: Ta ka dërguar ty e ke me protokoll.

Sekretare e Këshillit E.Naçi: Ankesën nuk e ke drejtuar tek mua e ke drejtuar në prefekti.

Këshilltar E.Nexhpi: Po diskutojmë për buxhetin jo për këto tema.

Këshilltar E.Bregu: Nga diskutimi im këtë ve re, nuk e ve re thelbin por ve re garniturën. Tani pasi u miratua paketa fiskale e cila në këtë moment është momenti procedural për të bërë ankesën e vërtetë, është bërë një ankesë dhe prefekti ka kthyer përgjigje në datën 21 shkresa është protokolluar këtu në datën 22 dhe ne nuk na u vu në dispozicion por në datën 27 ditën e komisionit pasi unë i kam kërkuar sekretares mos ka erdhur gjë shkresa sepse duhet të kishte erdhur të vihej në dispozicion ajo u përgjigj që po me ka erdhur shkresa dhe do ta dërgoj dhe e ka dërguar në datën 28 me këmbëngulje. Të gjithë këtë e bën me qëllim që mos ketë efekt procedural për të plotësuar afatet e ankimimit, pra duke pasur parasysh që ne si këshilltarë gjithë kohës jemi përpjekur të japim kontributin tonë në përmirësimin e qeverisjes shikojmë që ju gjithçka e keni me hile nuk keni asgjë reale, bëni konsultime false cakton këshilli konsultimet nuk vjen administrata, u caktuan takimet e tre rajoneve, rajoni 1 në orën 4, rajoni 2 në orën 5 dhe rajoni 3 në orën 6 dhe salla e bibliotekës ishte e mbyllur, drejtuesja tha që nuk kemi njoftim që do zhvillohet mbledhje mos ndoshta e bëjnë diku tjetër dhe për këtë është dëshmitar dhe Klajdi që vajti në orën 4 unë vajta në orën 5 dhe të dy kemi marrë të njëjtën përgjigje nga drejtuesja e bibliotekës.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Keni kaluar minutazhin dhe po bëheni qesharak me këto diskutime.

Këshilltar E.Bregu: Nuk keni bërë asgjë nga ato që kërkon komuniteti taksa paguesi për të bërë atë që duhet. Tani kryetari i bashkisë tha që prioritetet tona dhe në materialin që na është dërguar ishin turizmi, buqësia dhe inovacioni sot na kishte shtuar dhe një të katërt rininë sepse në material nuk e kishim duke pasur parasysh që kanë qënë prioritetet buqësia dhe turizmi në komisionin e financës unë u mundova që të bëja pyetjet e duhura që të harxhoja sa më pak kohë këtu kam marrë përgjigje që për buqësinë nuk kemi investime ka vetëm shpenzime mirëmbajtje

ndërkohë që kryetari sot na tha që kemi dhe disa investime për shtrim rrugësh, nga banorët kemi marrë gjithë kohës ankesa që kanalet kulluese janë të bllokuara dhe nuk mirëmbahen ndërkohë që nëqoftëse do kishte pasur vëmendje për të ndihmuar buqësinë ashtu siç kanë erdhur kërkesat nga banorët që kanë problematika të ndryshme përfshirë dhe sigurimin e prodhimit nga dëmtimet dhe kryetari tha që kjo është një çështje që bëhet midis fermerit që duhet të paguajë primin e sigurimit sepse ai meqënëse e ka biznes duhet të paguajë primin dhe të sigurohet që të marrë përfitimin dhe unë e di shumë mirë procedurën por kam biseduar dhe me shumë fermerë që ata janë të gatshëm ta paguajnë por problemi është që kryetari nuk është kujdesur fare që të diskutojë se çfarë ka nevojë buqësia dhe fermerët jep këtë përgjigje, problemi është që kompanitë e sigurimit nuk e marrin riskun përsipër. Për sa i përket investimeve në turizëm, i vetmi investim në turizëm që parashikohet është përgjigjia e administratës në komisionin e ekonomisë dhe financës është një instalacion me vlerë 7 milion e 600 mijë lekë thanë ndërsa investime të tjera nuk ka në turizëm, të gjitha të tjerat janë shpenzime të cilat sipas raportit të KLSH janë përkthyer në abuzime prandaj nuk bëhen investime më tepër sepse janë të nevojshme vetëm shpenzime të cilat përfitojnë disa persona si kryetari i bashkisë me njerëzit rreth e rotull tij.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Kujdes me fjalorin, nuk mund të të lejojmë të fyhesh.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Dilju për zot fjalëve të tua dhe respekto kohën.

Këshilltar E.Bregu: Do mbaroj me buqësinë dhe do të ta them, në lidhje me zonat rurale duke pasur parasysh që ato kanë nevojë dhe për transportin publik kemi diskutuar në komisionin e ekonomisë dhe financës dhe administrata na ka dhënë përgjigje që ofrojmë transport publik në dy tre fshatra nga gjithë bashkia e Korçës dhe jo në të tjerat dhe kjo në një orar kohe të kufizuar , pra transporti publik nuk po ofrohet nëpër fshatra. Në komisionin e ekonomisë administrata na ka thënë kur e kemi pyetur shtresat e veçanta, shtresat në nevojë të cilat përfitojnë udhëtimin falas nga transporti publik në zonat rurale e kemi pyetur e përfitojnë apo jo dhe na është thënë që duhet të aplikojnë në bashki që të marrin kartën dhe të përfitojnë ndërkohë që nga fjala që dëgjova nga kryetari tha që edhe këtë shërbim e ofrojmë vetëm për qytetin nëqoftëse është shprehur gabim ose e kam kuptuar unë gabim i lutem të më korrigjojë. Tani për sa i përket abuzimeve të kryetarit sepse është pjesë e buxhetit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Të lutem deri këtu mund të flasësh.

Këshilltar E.Bregu: Ma ka kërkuar Kryetari shpjegimin dhe nuk kam pse të përgjigjem ty.

Sekretare e Këshillit E.Naçi: Ka kryer shkelje dhe duhet të nxiret jashtë.

Këshilltar K.Pllaha: Të lutem Eva nuk ndalohet fjala e opozitës sepse nuk ka asnjë fyerje.

Këshilltar P.Tollkuci: Zonja Kryetare, Zotëria mbase do që të prishë seancën por ne nuk mund të prishim seancën për zotërinë dhe ka një etikë komunikimi ju lutem.

Këshilltar E.Bregu: Të ndërpreu njeri ty kur fole, se po na thojë se sa bukur të kanë votuar ty votuesit me votat e manipuluar.

Këshilltare A.Përmeti: Unë si qytetare nuk mund të rri dot në këtë sallë dhe fëmijët tanë na ndjekin ne online me këtë gjuhë që po flasim këtu pra ne duhet të kemi të parën etikën dhe edukatën dhe nëqoftëse shëmbulli që i japim ne është të bërtasim dhe të fyejmë njëri-tjetrën është gabim.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ne duhet të respektojmë mbajtjen e etikës sepse mbase e shihni unë kur fola fola pak gjatë për modelet dhe është problem shumë i madh në Shqipëri dhe modele kështu të shtrembëta kemi kudo dhe këtu nuk është vendi për të debatuar, është vendi për të dhënë ide.

Maestro Kostika Tanto: Ne si formacion i orkestrës të harqeve i kemi kërkuar Kryetarit të Bashkisë rritje pagash sepse me ato paga të ulta nuk mund tja dalim dot, e kemi takuar dhe vetë kryetarin.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Është e vërtetë që kemi bërë takimin në bashki por nuk ju kam thënë që jam unë i papërgatitur ju kam thënë të kundërtën ju kam thënë që jeni ju të papërgatitur dhe këtë ju thashë edhe këshilltarëve sepse të kërkosha takim me kryetarin e bashkisë me një kërkesë që duam të na rritet pagesa dhe komenti i vetëm është që ne jemi profesionistë më të mirë se të formacioneve të tjera unë këtë nuk e bëj. Argumenti i vetë në takim ka qënë mbase jo nga ty nga disa të tjerë pjesë e formacionit sesi mund të na trajtosh ne ti njëlloj me formacionet e tjera dhe me pas të kam pyetur ku e mbështesni këtë gjë dhe të kam thënë hajdeni të përgatitur dhe të kam pyetur sa kohë ke që të ka mbështetur bashkia e tanishme më ke thënë 6-7 vjet, unë do mbështes çdo formacion artistik në qytetin e Korçës i cili jep kontribut për jetën artistike dhe kulturore kontribut të matshëm në jetën artistike dhe kulturore të qytetit të Korçës sepse unë kam shumë alternativa për të mbushur jetën artistike dhe kulturore me një buxhet X lekë unë mund të mbështes formacionin tuaj por unë shoh produktin, unë produktin e orkestrës e shoh në jetën artistike dhe kulturore të qytetit. Ne prap kemi parashikuar një rritje për të gjitha formacionet por po ta them unë rritje për artistët me gjithë respektin që kam për artistët por artistë që kërkojnë vetëm shpërblim pa e matur me çfarë japin në jetën kulturore dhe artistike të qytetit unë këtë nuk e pranoj.

Këshilltar L.Petri: Ndjesë sepse u zgjatëm shumë në këtë temë por unë jam në dijeni dhe kam letrën që është dërguar në lidhje me këtë kërkesë dhe nuk mendoj që duhet marrë për argument më the ctë thash por dokumenti i shkruar. Kërkesa është me lëndë mbështetje për orkestrën e harqeve drejtuar Kryetarit të Bashkisë Korçë Z.Sotiraq Filo në dijeni të Kryetares të Këshillit Bashkiak ZNJ.Ana Verushi dhe Nënkyetares të Bashkisë Korçë Znj.Benila Tërova ne anëtarët e Formacionit të Orkestrës të Harqeve pranë bashkisë Korçë prej vitesh 2016 deri sot të përfaqësuar nga instrumentistë profesionistë kemi dhënë dhe japim kontribut të çmuar në gjallërimin e jetës kulturore artistike të qytetit tonë. Kanë marrë pesë çmime të dyta, dy çmime një për Vepra Më e Mirë Shqiptare dhe çmimi i parë si instrumentisti më i mirë solist.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Meqënës diskutimet në lidhje me Projekt Buxhetin 2024 dhe PBA 2024-2026 kanë përfunduar hap votimin për buxhetin 2024.



Hidhet ne votim dhe miratohet

Vota PRO 27

Vota KUNDËR 5

Vota ABSTENIM 0

**Pika 10 e rendit të ditës.**

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR RIDHËNIEN ME QIRA, TË TRUALLIT ME SIPËRFAQE 205 M2, PJESË E PASURISË NR.2/353 ZK 8563M, PËR QËLLIME BIZNESI .

Këshilltar E.Nexhipi: Komisioni i Ligjeve dhe Rregullores u mbledh për këtë çështje pasi shqyrtoi materialin është një praktikë e ndjekur disa vite rresht për një truall që lëshohet me qera për nevojat e biznesit, është një praktikë në përputhje me ligjin ju ftoj ta votojmë.

Hidhet ne votim dhe miratohet

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 4

**Pika 11 e rendit të ditës.**

INFORMACION PËR NXJERRJEN JASHTË PËRDORIMIT TË MATERIALEVE TË NDËRMARRJES TË SHËRBIMEVE PUBLIKE.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: E keni informacionin në material, atëherë unë do ju thoja që dhe braktisja e mbledhjes nga këshilltarët është shkelje. Meqënëse jemi në prag të festave, ju uroj tja kaloni gëzuar këto festa!

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva Naçi

**KRYETARI**

**ANA VERUSHI**

